


PËRSE DUHEJ PËRKTHYER PËRSËRI NË SHQIP ROMANI "NJËQIND VJET VETMI"



PËRKTHIMI I
ROBERT SHVARCIT
NGA GJERMANISHTJA
përballë
PËRKTHIMIT TË
MIRA MEKSIT
NGA ORIGINALI

TË DY PËRKTHIMET
përballë GJASHTË
GJUHËVE TË HUAJA

Shënime të redaktorit
Nga BUJAR HUDHRI



Page 2-16

Turqizmat

e përdorura nga
ROBERT SHVARC,
në përkthimin e
romanit

Njëqind vjet vetmi,
përballë

shqipes

së

NAIM FRASHËRIT

Prandaj edhe **jabanxhinjtë** ishin të vetmit
që e kuptonin arsyen, pse ai djaloshi që pat
qenë komandant i truprojës, kishte vdekur
nga **sevdaja**. (Faqe 180)

...mëngjesin e Vitit të Ri, e gjetën të vdekur
nga **sevdaja** poshtë dritares së saj. (Faqe 228)

Dhe vërtet, nuk kaloi shumë kohë dhe ajo i
tregoi të atit se kishte rënë në **sevda**. (Faqe 268)

ROBERT SHVARC
Tiranë, 1998

Njëqind vjet vetmi, Botimet Enciklopedike

BUKURIJA
(poemth)

Posa pashë Bukurinë,
Zemrën' e varfrë m'a piku,
Ndjeva në të **dashurinë**,
Që më erdh, dhe më s'më iku,
Pse s'ka fjalë të dëftenjë
Dashurin' e Bukurinë,

NAIM FRASHËRI
Stamboll, 1885
Ëndërrimet



Botohen për herë të parë

VISAR ZITI
DORËSHKRIME
ORIGINALE
ME POEZITË
E BURGUT

Bienale e
Venecias, 10
veprat më të
zhurmshme
të artit

(Fq. 18)

BIBLIOTEKË

BARËRAT E
SË KEQES

SHKËLQIM
ÇELA



PËRSE DUHEJ PËRKTHYER PËRSËRI NË SHQIP “NJËQIND VJET VETMI”

Shënime të redaktorit




Nga BUJAR HUDHRI


AVENTURA IME SI BOTUES I ROMANIT “DOKTOR ZHIVAGO” TË BORIS PASTERNAKUT

Plot njëzet e pesë vjet më parë, më 1994, kur isha një botues i ri në Elbasan, nxora në dritë romanin “Doktor Zhivago”. Kureshtjen tonë në vitet e diktaturës e kishte nxitur aq shumë romani i Kadaresë “Muzgu i perëndive të stepës”. Madje një fjali të këtij romani: *Doktor... doktor... ndihmë... jam keq... ah... doktor Zhivago... doktor Zhivago... i poshtër...* ende e kam të ngulitur në mendje sot e kësaj dite. Ndaj, kur përkthyesi i njohur Fatos Shmili më ofroi për botim pjesën e parë të romanit, nuk kisha ngurrimin më të vogël. E njihja përkthyesin nga dy libra të Turgenievit, “Dashuria e parë” dhe “Asja”, e dija që kishte përfunduar studimet për gjuhë ruse dhe tashmë ishte mësues në pension. M’u duk vetja me fat, kisha një besim të madh tek ai. Madje, shprehja italiane “traduttore-traditore” atëkohë më dukej krejt e pavend, aq besim kisha te përkthyesi. Shto këtu që m’u desh që për ta redaktuar dorëshkrimin ta

merrja me vete në një kurs për botues në Nju-Jork. S’është e vështirë të kuptohet se sa i vëmendshëm mund të kem qenë në punën time si redaktor. Dalja e romanit kaq shumë të përfolur ngjalli shumë interesim dhe nisi të shitej mirë. Dëgjoja shumë fjalë lavdëruese, çka mua, një botues i ri që vinte nga Elbasani, më dukej se kisha arritur majat, që me një botim të tillë, të munguar prej vitesh, të tërhiqja vëmendjen e të gjithëve. Por një ditë vjen në zyrën time Shpëtim Karaj, ish-drejtori i bibliotekës së rrethit, një burrë shumë i kulturuar, njohës i shkëlqyer i frëngjishtes. Kisha botuar prej tij përkthimet e dy dramave të Eugene Ionesco-s (“Vrasës pa shpërblim” dhe “Mbreti po vdes”). Ndërsa prisja që të më përgëzonte për botimin e “Zhivagos”, ai më lëshoi bombën: si ka mundësi, ti, që përgjëroheshe për lexuesit. Mezi e kapa mendimin e tij: nuk duhej ta kisha botuar këtë përkthim! Nuk ishte përkthyer saktë! Po nga e di ti, munda ta kundërshtoja me gjysmë zëri, i zënë në befasi nga qortimi i tij. E kam parë nga frëngjishtja, më tha. Por, siç duket, ti nuk e ke parë fare nga rusishtja jote. U desh një javë punë që të

kuptoja se pasaktësitë ishin më të mëdha sesa ato që kishte konstatuar përkthyesi nga frëngjishtja dhe mora një vendim të prerë: mbledha të gjithë librat e shpërndarë nëpër librari (atëherë kishte shumë më tepër librari se sot) dhe i çova për karton. Por momenti më i vështirë ende nuk kishte ardhur. Më vjen në zyrë përkthyesi Fatos Shmili me një dosje ku ishte dorëshkrimi i pjesës së dytë të romanit. Ishte i gëzuar, kishte marrë kaq urime e përgëzime që kishte realizuar ëndrrën e tij dhe të brezit të tij... Ndërsa unë po formuloja gjithë siklet mendimin se si t’i thosha për vendimin që kisha marrë. Pashë që u zverdh në fytyrë dhe m’u drejtua: ah, e kuptova, të ka thënë ai, komunisti. Nuk na u ndanë as në demokraci këta! I thashë që ishte mendimi dhe vendimi im. Për ta konkretizuar, mora dollarët nga dieta që kisha kursyer në Nju-Jork dhe i pagova edhe pjesën e dytë që s’do të botohej kurrë nga “Onufri”. Zgjati dorën e majtë dhe ndërsa mori zarfin me dollarë, me gishtin tregues të dorës së djathtë më kërcënoi se do të shiheshim së shpejti në gjyq. I miri Fatos Shmili, nuk e bëri kurrë këtë veprim. E kujtoj gjithmonë





këtë moment të vështirë të jetës sime, trishtimin në sytë e përkthyesit, sa herë që më duhet të jem i qartë dhe i prerë kur të vendos se duhet botuar apo jo një libër. Por mora një mësim që s’do ta harroj kurrë në jetë: që të zësh mend, duhet të paguash gabimet e tua. Që të botosh një përkthim, duhet patjetër ta përballësh me origjinalin. Dhe nga Shpëtim Karaj mësova se si mund ta kontrollosh një përkthim, duke e parë nga gjuhë të tjera. Kjo ishte aventura ime me “Zhivagon”.

Ky roman i rëndësishëm u botua më pas nga kolegu im i “Uegen” dhe së fundi, çerek shekulli pas botimit tim, vitin e kaluar (2018) e botoi kolegu tjetër, ai i “Fan Nolit”. E bleva këto ditë dhe isha kureshtar ta krahasoja se si ishte përkthyer faqja e parë. Lexoj titullin e kapitullit të parë. E lexoj edhe një herë, por nuk po u besoja syve. Ishte përkthyer “TRENI I SHPEJTË PESORËSH”. Shikoj librin që kam botuar dhe lexoj germë për germë “EKSPRESI I ORËS PESË”. Shikoj titullin në rusisht “ПЯТИЧАСОВОЙ СКОРЫЙ”. Po ku është aty fjala “tren”? Po si mund të jetë një tren pesëorësh? Apo pesëmuajsh? Thua se është një qenie e gjallë!

Pa asnjë dyshim, përkthyesi i ndjerë Fatos Shmili e ka absolutisht të saktë këtë titull!

Nuk është e domosdoshme aspak të dish origjinalin rusisht, që të mos bësh një gafë të tillë. Shpejtësia e trenit nuk matet me orë, por me km/orë. Ndërsa udhëtimi matet me orë. Kurse aty bëhet fjalë për diçka fare të qartë dhe logjike: ora, çasti, koha kur niset një tren!

Meqenëse përkthyesja e romanit, zonja Xhemile Zyka, është edhe bashkëhartuese e fjalorit rusisht-shqip, dhe kolegu im i nderuar, botuesi i parë privat në Shqipëri, zoti Rexhep Hida, po ashtu ka studiuar për gjuhë ruse, këto që shpreha më sipër unë po ua ilustruj me fjalorin e gjuhës ruse.

[...**ЧАСОВОЙ**, -ая, -ое. Вторая составная часть сложных слов, обозначающая: продолжающийся столько-то часов (сколько указано в первой части), назначенный на такой-то час пополудни или пополудни (какой указан в первой части), например: трехчасовой, пятичасовой.]

[...i/ e orës. Pjesa e dytë e fjalëve të përbëra, që shënojnë: se sa orë vazhdon (aq sa tregohet në pjesën e parë); i caktuar që më parë në orën (aq sa tregohet në pjesën e parë), për shembull: i orës tre, i orës pesë.]

Për koincidençë, shembulli në fjalorin e gjuhës

Titulli i origjinalit:

Борис Пастернак
Доктор Живаго

Copyright © Giangiacomo Feltrinelli Editore, 1957
First published as *Il Doctor Zhivago* in November 1957
by Giangiacomo Feltrinelli Editore, Milan, Italy

© i botimit shqip “Fan Noli”

Redaktor Rexhep Hida



The publication of this book was effected under the auspices of the Mikhail Prokhorov Foundation TRANSCRIPT Programme to Support Translations of Russian Literature

Falënderojmë Fondacionin Mikhail Prokhorov Programi TRANSCRIPT për mbështetjen e dhënë në botimin e këtij libri

ISBN 978-9928-251-37-4

Pjesa e parë

TRENI I SHPEJTË PESËORËSH

1

Ecnin, ecnin dhe këndonin këngën “Kujtimi i përjetshëm”, dhe, kur ndalonin, duke sikur vazhdonin ta këndonin këmbët, kuajt, era që frynte.

Kalimtarët i hapnin rrugën kortezhit, numëronin kurorat, pyesnin, bënin kryq. Kureshtarët bashkoheshin me kortezhin, pyesnin: “Kush ka vdekur?” Atyre u përgjigjeshin: “Zhivago”, - “Aaa, atëherë është e qartë”. - Jo ai vetë. Ajo.” - “Gjithsesi. Mbretëria Qiellore. Varrim i pasur”.

Vezullonin minutat e fundit, të numëruara, të pakthyeshme. “Zonja tokë dhe vullneti i saj, gjithësia dhe gjithçka që jeton mbi të”. Prifti me një lëvizje në formë kryqi hodhi një grusht dhe mbi Maria Nikollajevnën. U këndua “Me frymën e të drejtëve”. Filloi një garë e nxituar veprimesh. E mbyllën arkivolin, e mbërthyen, filluan ta lëshonin në varr. Mbi të kërciste breshëria e topthave të dheut që mbushnin me nxitim varrin me katër lopata. U formua, kështu, një kodrinë e vogël. Një djalë dhjetëvjeçar hipi mbi të.

Vetëm në gjendje mpirjeje dhe pandjeshmërie, që shfaqen zakonisht nga fundi i varrimeve të mëdha, mund të mendohej se djali donte të fliste mbi varrin e nënës.

Ai ngriti kokën dhe që andej hodhi një vështrim të përhumur

7

ruse është po ai i titullit të kapitullit të parë: [пятичасовой – i orës pesë].

Kur është përkthyer gabim, që titulli i kapitullit të parë të librit, mbase, për hir të lexuesit, do t’ua sugjeroja të ndiqnin shembullin tim. Ndoshta, duhet një përkthim tjetër i “Zhivagos”!

ZHGËNJIMI I PARË ME PËRKTHIMIN E ROBERT SHVARCIT NË VITIN 1999

Pesë vjet pas dështimit të botimit tim të romanit “Doktor Zhivago”, në Tiranë po bënte bujë përkthimi prej Robert Shvarcit i romanit “Njëqind vjet vetmi”. Meqenëse nuk më pëlqeu aspak cilësia e librit (lloji i germës, i letrës, ngjitja), s’di pse pata një lloj padëshire për ta lexuar. Por kureshtja ishte aq e madhe, sa nuk mund të mos e filloja leximin. Befasia ishte e madhe kur ndesha fjalinë e katërt të romanit:

“Një arixhi trupmadh, me një mjekër të kreshpëruar e me ca gishtërinj si kthetër harabeli, që u paraqit me emrin Melhiades, **ia ekspozoi miletit** të fshatit atë që ai e quante **mrekullinë e tetë dijetarëve** alkimistë të Maqedonisë.”

Nuk po u besoja syve. Megjithatë, që të bindesha se nuk e kisha gabim, mora faqen e parë të përkthimit të Shvarcit dhe e krahasova me variantin spanjisht, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht dhe rusisht. Pjesa e dytë e kësaj fjalie:

...**ia ekspozoi miletit** të fshatit atë që ai e quante **mrekullinë e tetë dijetarëve** alkimistë të Maqedonisë, ishte përkthyer krejtësisht gabim!

[spanjisht]: ...**la octava maravilla de** los sabios alquimistas de Macedonia.

[gjermanisht]: ...**das achte Wunder der** alchimistischen Weisen Mazedoniens nannte.

[anglisht]: ...**the eighth wonder of** the learned alchemists of Macedonia.

[frëngjisht]: ...**la huitième merveille des** savants alchimistes de Macédoine.

[italisht]: ...**l’ottava meraviglia dei** savi alchimisti della Macedonia.

[rusisht]: ...**восьмое чудо света**, сотворенное, по его словам, учеными-алхимиками из Македонии.

Çfarë kishte ndodhur? Numërori rreshtor **i/e tetë** (mrekullia e tetë) ishte shndërruar në numëror themelor: **tetë** (tetë dijetarë alkimistë

të Maqedonisë). Dhe Shvarci nuk e përkthen “**mrekullia e tetë** (e botës)”, por “**e tetë dijetarëve**”. Ishte një gafë që vetëm një fillestar mund ta bënte. E krahasuar me variantet e gjuhëve të mësipërme, por edhe bazuar në logjikën e një lexuesi të zakonshëm, ishte e mjaftueshme që të mos e vazhdoje leximin e librit.

Kam parë më vonë edhe një botim tjetër të romanit “Njëqind vjet vetmi”, tashmë të botuar nga kolegu im i nderuar i “Horizont”, botim i vitit 2004, me shpresën se mos, vallë, varianti i botuar nga “Botimet Enciklopedike” ishte një gabim shtypi, por jo! Edhe pas gjashtë vjetësh, kjo fjali ishte identike. Pa përmendur këtu edhe dy fjalët pranë njëra-tjetrës, **ia ekspozoi miletit**, që më dukej një nivel i rëndomtë përkthimi, krahasuar me një emër të madh e të padiskutueshëm si Robert Shvarc. Po për këtë do të flasim më poshtë.

NË KËRKIM TË AGJENCISË LETRARE TË G. G. MARKEZIT

Ishte viti 1999, kur në planet e mia si botues shënova botimin e veprës së Markezit. Kjo ka lidhje me njohjen dhe fillimin e bashkëpunimit me shkrimtaren dhe përkthyesen e njohur Mira Meksi, sidomos me botimin e romanit “Dashuria në kohërat e kolerës”. Por blerja e të drejtave të autorit dukej si një mision i pamundur, sepse romani “Njëqind vjet vetmi” ishte botuar pa të drejta autori dhe për këtë arsye, Agjencia Letrare e Markezit nuk jepej asnjë leje tjetër. Në Tiranë atëherë debatohej se kush i kishte të drejtat e përkthimit, “Botimet Enciklopedike” apo përkthyesi Robert Shvarc, por askush nuk kujtohej për një fakt të rëndësishëm: si mund të botohej pa të drejta autori një kryevepër si “Njëqind vjet vetmi”? Pikërisht, përkthimi i pasaktë i faqes së parë dhe botimi pirat i romanit më nxitën që të ngulmoj, prej 15 vjetësh, derisa “Onufri” mori të drejtat për gjuhën shqipe nga Agjencia e Markezit.

KUSH DUHEJ TA RIPËRKTHENTE ROMANIN

Problemi kryesor, pasi i siguruam të drejtat e autorit për romanin “Njëqind vjet vetmi”, ishte se kush do ta përkthente. Në parathënien e Robert Shvarcit me rastin e botimit të parë të romanit, ai çmon shumë lart përkthimin mjeshtëror të Aurel

Plasarit me novelat “Gjethurinat”, “Kolonelit nuk ka kush t’i shkruajë” dhe “Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar” si dhe përkthimin tjetër mjeshtëror të Mira Meksit, “Dashuria në kohërat e kolerës” dhe “Dymbëdhjetë tregime pelegrine”. Kanë qenë biseda të gjata, të vështira dhe të shumta me dy përkthyesit e mirënjohur. Më ka prekur vlerësimi i tyre për punën dhe kujtimin e mikut të tyre Robert Shvarc dhe i kam mirëkuptuar dhe e kam çmuar fort sjelljen e tyre. Sot është e vështirë të gjesh mirëkuptim midis krijuesve apo vlerësim për njëri-tjetrin. Por problemi që unë kam shtruar me të dy përkthyesit e mirënjohur, ka qenë vetëm një: nuk e meriton lexuesi shqiptar ta ketë këtë libër të përkthyer nga origjinali! Nuk ka asnjë kuptim që vetëm lexuesi shqiptar ta lexojë të përkthyer nga një gjuhë e dytë, kur e gjithë bota e ka përkthyer nga spanjishtja.

Isha me fat si botues, por sidomos me fat do të jenë lexuesit shqiptarë kudo në botë, që Mira Meksi pranoi ta përkthente nga origjinali këtë kryevepër të letërsisë botërore.

PËRKTHIMI NGA GJERMANISHTJA
I ROBERT SHVARCIT
PËRBALLË PËRKTHIMIT
NGA ORIGJINALI TË MIRA MEKSIT

Ndonëse në pamje të parë ky krahasim duket pa kuptim, arsyeja e vërtetë përse e bëj, si redaktor i librit, është që lexuesi të ketë një ide të qartë se si është përkthyer ky roman dhe si duhej përkthyer. E di që ky krahasim e favorizon përkthyesen Mira Meksi: përkthimi nga origjinali, përkthimi kur kanë kaluar njëzet vjet nga ai i Robert Shvarcit, përvoja si dhe mundësitë e sotme që kanë përkthyesit nga përdorimi i internetit. Pikërisht, për ta zbutur këtë përballje, do të rreshtojmë krahas përkthimit të Shvarcit edhe gjashtë gjuhë të tjera: 1. spanjisht, meqenëse është origjinali; 2. gjermanisht, është gjuha nga e ka përkthyer Shvarci; dhe gjuhët e tjera: anglisht, frëngjisht, italisht dhe rusisht. Si të thuash, me fjalë të tjera, të shtatë “kundër” variantit të Mira Meksit.

PËRKTHIMI I FJALISË SË PARË TË
ROMANIT

Një studiues ka thënë se vetëm me fjalinë e parë te romanit "Njëqind vjet vetmi", Markez ka krijuar një botë të tërë. Rëndësia e fjalisë së parë të romanit çmohet aq shumë nga shkrimtarët, sa, shumë prej tyre, i kanë kushtuar muaj apo vite. Prandaj, përkthimi i kësaj fjalie ka një vlerë të veçantë për të kuptuar se cili është niveli i përkthyesit.

Pikërisht, në këtë fjali, e cila është bërë ikonike, ndër më të bukurat e letërsisë botërore, përkthyesi Robert Shvarc ka shtuar dy fjalë nga vetja e tij. Që nuk janë as në variantin gjermanisht, prej nga e ka përkthyer.

1.

[R. Sh.] **Shumë e** shumë vjet më vonë, kolonelit Aureliano Buendia, **i ndodhur** përballë togës së pushkatimit, do t’i kujtohej ajo pasdreke e largët, kur babai e mori me vete për ta njohur me akullin.

[Përkthyesi ka shtuar që në krye fjalën "**Shumë e**", si dhe "**i ndodhur**". Duke e dobësuar shumë këtë fjali. Madje, mënyra se si janë renditur tashmë fjalët "**Shumë e** shumë vjet më vonë", të duket sikur po lexon një përrallë. Për fat të keq, janë pafund rastet, që nga faqja e parë deri tek e fundit, që përkthyesi ka shtuar nga vetja fjalë dhe shprehje që nuk janë origjinal.]

[M.M.] Shumë vjet më vonë, përballë togës së

pushkatimit, kolonel Aureliano Buendia-s do t’i kujtohej ajo pasdite e largët kur i ati e çoi të shihte akullin.

[sp.] Muchos años después, frente al pelotón de fusilamiento, el coronel Aureliano Buendía había de recordar aquella tarde remota en que su padre lo llevó a conocer el hielo.

[gj.]Viele Jahre später sollte der Oberst Aureliano Buendía sich vor dem Erschießungskommando an jenen fernen Nachmittag erinnern, an dem sein Vater ihn mitnahm, um das Eis kennenzulernen.

[angl.] Many years later as he faced the firing squad, Colonel Aureliano Buendía was to remember that distant afternoon when his father took him to discover ice.

[fr] Bien des années plus tard, face au peloton d’exécution, le colonel Aureliano Buendia devait se rappeler ce lointain après-midi au cours duquel son père l’emmena faire connaissance avec la glace.

[it.] Molti anni dopo, di fronte al plotone di esecuzione, il colonnello Aureliano Buendia si sarebbe ricordato di quel remoto pomeriggio in cui suo padre lo aveva condotto a conoscere il ghiaccio.

[rus.] Пройдет много лет, и полковник Аурелиано Буэндиа, стоя у стены в ожидании расстрела, вспомнит тот далекий вечер, когда отец взял его с собой посмотреть на лед.

2.

[R.Sh.] Bota ishte ende aq e re, saqë shumë gjëra nuk kishin as emër dhe, për t’i nxjerrë në pah, duheshin **rrëfyer me gisht**.

[Nuk mund të rrëfëhet me gisht. Prandaj thuhet “gisht tregues” dhe jo “gisht rrëfyes”.

Sipas FGjSSh:

Rrëfej :1. Tregoj (*një ngjarje*) 2. i them dikujt diçka (*sekret, mëkat*). 3. Dëgjoj rrëfimin e dikujt: (*e rrëfeu prifti*.)

Tregoj: 1. Bëj të duket; nxjerr në pah 2. I shpjegoj dikujt me fjalë ose shënoj me lëvizje të dorës.

Madje, dhe shembulli i FGjSSh ka si shembull pikërisht këtë shprehje: *nxjerr në pah*.]

[M.M.] Bota ishte aq rishtare, saqë shumë sendeve u mungonte emri dhe për t’i përmendur duheshin **treguar me gisht**.

[sp.] El mundo era tan reciente, que muchas cosas carecían de nombre, y para mencionarlas había que señalarías con el dedo.

[gj.] Die Welt war noch so jung, daß viele Dinge des Namens entbehrten, und um sie zu benennen, mußte man mit dem Finger auf sie deuten.

[angl.] The world was so recent that many things lacked names, and in order to indicate them it was necessary to point.

[fr.] Le monde était si récent que beaucoup de choses n’avaient pas encore de nom et pour les mentionner, il fallait les montrer du doigt.

[it.] Il mondo era così recente, che molte cose erano prive di nome, e per citarle bisognava indicarle col dito.

[rus.] Мир был таким первозданным, что многие вещи не имели названия и на них просто тыкали пальцем.

3.

[R.Sh.] Për çdo vit, ..., shpallte **shpikjet e fundit të botës**.

[*Dubet "shpikjet e reja" dhe jo sikundër e përkthen Shvarc. Nuk ka lidhje me botën, apo fundin e botës*]

[M.M.]...paraqisnin **shpikjet e reja**.

[sp.] ... a conocer **los nuevos inventos**.

[gj.]...**die neuesten Erfindungen** bekannt.

[angl.] Every year ... display **new inventions**.

[fr.] ... faisait part **des nouvelles inventions**.

[it.] ... conoscere le **nuove invenzioni**.

[rus.]... показывали **новейшие изобретения**.

4.

[R.Sh.] Një arixhi trupmadh, me një mjekër të kreshpëruar e **me ca gishtërinj si kthetër harabeli**, që u paraqit me emrin Melhiades, ia **ekspozoi milletit të fshatit** atë që ai e quante **mrekullinë e tetë dijetarëve** alkimistë të Maqedonisë.

[Në këtë fjali, përveç faktit që përmendëm më sipër kur ngatërrojnë numërorin rreshtor, me atë themelor, **mrekullinë e tetë dijetarëve**, duket e papranueshme fjala me origjinë latine **ekspozoi**, pranë një fjale bisedore turke, **milet**. Apo që harabeli të ketë kthetra.]

[M.M.]Një **cigan** trupmadh, me një mjekër ferishtë dhe me **duar si të trumcakut**, i cili u prezantua me emrin Melquíades, bëri në sytë e të gjithëve një demonstrim mizor të asaj që ai vetë e quante **mrekullia e tetë e alkimistëve të ditur** të Maqedonisë.

[sp.]Un gitano corpulento, de barba montaraz y manos de gorrión, que se presentó con el nombre de Melquiades, hizo una truculenta demostración pública de lo que él mismo llamaba la octava maravilla de los sabios alquimistas de Macedonia.

[gj.]Ein massiger Zigeuner mit wildem Bart und Spatzenfingern, der sich als Melchiades einführte, stellte öffentlich das zur Schau, was er das achte Wunder der alchimistischen Weisen Mazedoniens nannte.

[angl.] A heavy gypsy with an untamed beard and sparrow hands, who introduced himself as Melquíades, put on a bold public demonstration of what he himself called the eighth wonder of the learned alchemists of Macedonia.

[fr.] Un gros gitan à la barbe broussailleuse et aux mains de moineau, qui répondait au nom de Melquiades, fit en public une truculente démonstration de ce que lui-même appelait la huitième merveille des savants alchimistes de Macédoine.

[it.] Uno zingaro corpulento, con barba arruffata e mani di passero, che si presentò col nome di Melquíades, diede una truculenta manifestazione pubblica di quella che egli stesso chiamava l’ottava meraviglia dei savi alchimisti della Macedonia.

[rus.]Коренастый цыган с кудлатой бородой и воробыными руками-лапками назвал свое имя – Мелькиадес – и стал демонстрировать обомлевшим зрителям не что иное, как восьмое чудо света, сотворенное, по его словам, учеными-алхимиками из Македонии.

5.

[R.Sh.] Këtë radhë sollën **me vete një dylbi me një thjerrëzë** të madhe sa një dajre,

[*Bëhet fjalë për tejqyrë dhe thjerrëzë, jo dylbi me thjerrëzë*.]

[M.M.]Kësaj here sollën një **tejqyrë** dhe **një lente sa një tambur**,

[sp.] Esta vez llevaban un catalejo y una lupa del tamaño de un tambor,

[gj.] Diesmal brachten sie ein Fernrohr und eine trommelgroße Lupe mit,

[angl.] This time they brought a telescope and a magnifying glass the size of a drum,

[fr.] Cette fois, ils apportaient une lunette d’approche et une loupe de la dimension d’un tambour,

[it.] Questa volta traevano un cannocchiale e una lente grande come un tamburo,

[rus.] На этот раз они принесли подзорную трубу и лупу величиной с бубен

6.

[R.Sh.] I **ndodhur përballë** qortimeve të **ashpra** të së shoqes të tmerruar **për shkak të mendjes së tij aq pjellore, por me pasoja aq të rrezikshme**, ai e **humbi toruan** dhe ment i vuri flakën **gjithë** shtëpisë.

[*Fjali e zgjeruar me fjalë pa kuptim. Larg origjinalit*]

[M.M.]Nga qortimet e së shoqes së trembur **prej këtyre shpikjeve kaq të rrezikshme**, përdesh i vuri zjarrin shtëpisë.

[sp.] Ante las protestas de su mujer, alarmada por tan peligrosa inventiva, estuvo a punto de incendiar la casa.

[gj.] Angesichts der Einwände seiner über eine so gefährliche Erfindungsgabe entsetzten Frau war er nahe daran, das Haus in Brand zu stecken.

[ang.] Over the protests of his wife, who was alarmed at such a dangerous invention, at one point he was ready to set the house on fire.

[fr.] Devant les récriminations de sa femme, alarmée par une si dangereuse inventivité, il faillit mettre le feu à la maison.

[it.] Nonostante le proteste di sua moglie, messa in apprensione da un'invenzione così pericolosa, poco mancò non incendiasse la casa.

[rus.] Да что там, — он не пожалел бы и собственный дом, если бы не бурные протесты жены, уstraшенной его опасными трюками.

7.

[R.Sh.] ...nga **trupi nuk e hiqte kaftanin e mëndafsh-të** që **dukej sikur** kishte zënë një shtresë **myku jeshil nga furtunat e viteve**.

[kaftani Rrobë e gjatë zakonisht prej mëndafshi dhe e stolisur, që mbanin zyrtarët e lartë turq. Në origjinal është jelek kadifeje]

Dhe në fund: **zgjyra e shekujve** dhe jo **furtunat e viteve**]

[M.M.]... dhe **një jelek kadifeje të lustruar nga zg-jyra e shekujve**.

[sp.] ... y un chaleco de terciopelo patinado por el verdín de los siglos.

[gj.] ... eine vom Grünspan der Jahrhunderte patinierte Samtjoppe.

[ang.]...and a velvet vest across which the patina of the centuries had skated.

[fr.] ... et un gilet de velours tout patiné par le vert-de-gris des siècles.

[it.] ..., e un panciotto di velluto patinato dalla bor-raccina dei secoli.

[rus.]..., и бархатный жилет, позелененный пати-ной веков.

8.

[R.Sh.] Por ja që **predispozita e përgjithshme drejt përparimit, ...**

[*Një raport i Bankës Botërore, do të ishte shprehur më bukur se sa varianti i Shvarcit.*]

[M.M.] Ai shpirt nismëtari u zhduk në pak kohë, ...

[sp.] Aquel espíritu de iniciativa social desapareció en poco tiempo,

[gj.] Doch dieser fortschrittliche Gemeinsinn wurde in kurzer

[ang.] That spirit of social initiative disappeared in a short time,

[fr.] Ce bel esprit d'initiative sociale disparut en un rien de temps,

[it.] Quello spirito di iniziativa sociale sparì in poco tempo,

[rus.] Но интерес к деятельности на пользу общества вскоре был вытеснен из души

9.

[R.Sh.] **Përsa i përkiste gjeografisë së rrethinave përtej fshatit të tij, Hose Arkadio Buendia nuk e kishte as haberin më të vogël.**

[*Sa shumë fjalë për një fjalë fare të thjeshtë!*]

[M.M.]José Arcadio Buendía nuk e njihte aspak gjeografinë e zonës.

[sp.] José Arcadio Buendía ignoraba por completo la geografía de la región.

[gj.] José Arcadio Buendía tappte über die Geogra-phie der Umgebung völlig im dunkeln.

[ang.] José Arcadio Buendía was completely igno-rant of the geography of the region.

[fr.] José Arcadio Buendia ignorait totalement la géographie de la région.

[it.] José Arcadio Buendia ignorava completamente la geografia della regione.

[rus.] Хосе Аркадио Буэндиа совершенно не разбирался в топографии местности.

10.

[R.Sh.] **Por Ursula nuk dëgjonte fare nga ai vesh dhe ëndrrat e tij me sy hapur nuk i bënin pikën e për-shtypjes.**

[*Kjo fjalë ka trefishin e fjalëve dhe çuditërisht mungon fjala kryesore: Largpamësi!*]

[M.M.][**Por [se] Úrsula nuk u prek nga largpamë-sia e tij.**

[sp.] Pero Úrsula fue insensible a su **clarividencia**.

[gj.] Doch Ursula war unempfindlich gegen seine **Hellsicht**.

[ang.]But Úrsula was insensible to his **clairvoyance**.

[fr.] Mais Ursula fut insensible à la pénétration de ses vues.

[it.] Ma Ursula fu insensibile alla sua **chiaroveg-genza**.

[rus.] Но Урсула не поддавалась его чарам **ясновидца**.

11.

[R.Sh.] ... dhe kish vdekur nga hemoragjia, pasi jetoi dyzet e dy vjet krejt i virgjër, ngaqë ish lindur dhe ish rritur **me një penis prej kërcëj në trajtën e një tapanxjerrësi** dhe me majën **si qime peneli**.

[Fjala **penis** nuk është në asnjë variant.]

[M.M.] ... dhe që vdiq nga hemorragjia pasi kishte jetuar dyzet e dy vjet në një qashtësi të plotë virgjërore, sepse lindi dhe u rrit me një **bisht prej kërcë** në formë **hapëseje** tapash [nxjerrëse tapash] që kishte një xhufkë qimesh në majë.

[sp.] ... y dos años en el más puro estado de virginidad porque nació y creció con una cola cartilaginosa en forma de tirabuzón y con una escobilla de pelos en la punta.

[gj.]..., nachdem er zweiundvierzig Jahre in keus-chester Jungfräulichkeit gelebt hatte, da er mit ein-em knorpeligen Korkzieherschwanz mit Pinselende geboren worden und herangewachsen war.

[ang.] ... after having lived forty-two years in the purest state of virginity, for he had been born and had grown up with a cartilaginous tail in the shape of a corkscrew and with a small tuft of hair on the tip.

[fr.]..., après quarante-deux ans d'existence dans le plus pur état de virginité,

car il était né et avait grandi pourvu d'une queue cartilagineuse en forme de tire-bouchon avec une touffe de poils au bout.

[it.] ... per quarantadue anni nel puro stato di verginità, perché era nato e cresciuto con una coda car-tilaginoso a forma di cavaturacciolo e con un pennello di setole sulla punta.

[rus.] ... после того как прожил на свете сорок два года в состоянии полнейшего целомудрия, ибо родился и рос с хвостом - хрящеватым крючком с кисточкой на конце.

12.

[R.Sh.] ..., kur një miku i tij kasap deshi t'i bënte nder duke ia prerë **majën e penisit** me satër...

[Përsëri fjala **penis**. Nuk është në original.]

[M.M.] ...kur një mik i tij kasap i bëri nder duke ia prerë me një **hanxhar mishi** [satër].

[sp.] ... cuando un carnicero amigo le hizo el favor de cortársela con una hachuela de destazar.

[gj.] ..., als ein befreundeter Schlachter ihm den Gefallen tat, **das Schwanzende** mit einem Hackmess-er zu entfernen.

[angl.] ... when a butcher friend did him the favor of chopping it off with his cleaver.

[fr.]..., et qui lui coûta la vie le jour où un ami bouch-er s'offrit à la lui couper d'un coup de hachoir.

[it.]... quando un macellaio amico suo gli fece il fa-vore di mozzarla con un marrancio.

[rus.] ..., когда приятель-мясник по его просьбе отрубил эту закорючку топором для разделки туш.

13.

[R.Sh.] Ajo shprehu mendimin se **përmasat shumë të mëdha të organit të tij gjenital** ishin diçka po aq e panatyrshme, sa edhe **penisi** prej bisht derrkuci i kushëririt të tij.

[**Organi i tij gjenital** dhe Fjala **penis** nuk janë në asnjë variant. Dhe nuk mund të ngatërrohet kurrë. Si mund të insistohet të shtohet nga përkthyesi!?

[M.M.]Kishte mendimin se **shpërpjesëtimi i tij** ishte po aq i panatyrshëm sa edhe **bishti prej derrkuci** i kushëririt.

[sp.] Pensaba que **su desproporción** era algo tan desnaturalizado como la cola de cerdo del primo.

[gj.] Sie **dachte**, sein **Unmaß** sei etwas so Un-natürliches wie der Schweineschwanz des Vetters.

[ang.] She thought that his **disproportionate** size was something as unnatural as her cousin's tail of a pig.

[fr.] Elle pensait que **la disproportion** dont il se trouvait affecté était quelque chose d'aussi contrenature que la queue de cochon du cousin.

[it.] Pensava che la **sua sproporzione** fosse qualcosa di snaturato come la coda di maiale del cugino.

[rus.] Необычайное развитие сына казалось ей чем-то столь же противоестественным, как поросычий хвост ее родственника.

14.

[R.Sh.] ...e bindur që çmenduritë e djemve të saj ishin po aq të kobshme sa ç'ishte edhe të lindurit me **një penis si bisht derrkuci**,

[Përsëri! Fjala **penis** nuk është në asnjë variant.]

[M.M.] ...e bindur se marrëzitë e të bijve ishin po aq të frikshme sa **edhe një bisht derri**,

[sp.] ...convencida de que las extravagancias de sus hijos eran algo tan espantosa coma una cola de cerdo

[gj.] ...überzeugt, daß die Überspanntheiten ihrer Söhne ebenso schlimm seien wie ein Schweine-schwänzchen,

[ang.] ...convinced that the wild behavior of her children was something as fearful as a pig's tail,

[fr.] ...convaincue que les excentricités de ses en-fants ne le cédaient en ignominie à une queue de co-chon,

[it.] ...che le stravaganze dei suoi figli fossero qualco-sa di tanto spaventoso quanto una coda di maiale,

[rus.] ...И, убежденная, что нелепые привычки ее потомков ничуть не лучше свиного хвоста,

15.

[R.Sh.] Aurelianoja doli **i veshur krejt në mëndafsh të zi**, midis Amarantës dhe Rebekës.

[*Duhet **kadife e zezë**. Jo mëndafsh, sipas Shvarcit.*]

[M.M.] Aureliano-ja u shfaq **i veshur me kadife të zezë** në mes të Amaranta-s dhe Rebecas.

[sp.] Aureliano apareció vestido de terciopelo ne-gra, entre Amaranta y Rebeca.

[gj.] Aureliano ganz in schwarzem Samt zwischen Amaranta und Rebeca.

[ang.] Aureliano appeared dressed in black velvet between Amaranta and Rebeca.
[fr.] Aureliano apparaissait tout habillé de velours noir, entre Amaranta et Rebecca.
[it.] Aureliano apparve vestito di velluto nero, tra Amaranta e Rebeca.
[rus.] Аурелиано, в черном бархатном костюме, стоит между Амарантой и Ребеккой.

16.

[R.Sh.] Në oborrin e brendshëm, do të **ndërtohej një hamam për gra e një për burra**,
[Përfytyroni një hamam në Karaibe!]

[M.M.] Urdhëroi të ndërtohej në patio, **një banjë për gratë dhe një tjetër për burrat**,
[sp.] Dispuso construir en el patio, un baño para las mujeres y otra para los hombres,
[gj.] Im Innenhof sollten ein Frauenbad und ein Männerbad gebaut werden,
[ang.] She had baths built is the one for the women and another for the men,
[fr.] Elle donna l'ordre que fussent construits dans le patio, un bain pour les femmes et un autre pour les hommes,
[it.] Ordinò la costruzione nel patio, di un bagno per le donne e di un altro per gli uomini,
[rus.] Во дворе, Урсула приказала соорудить две купальни: одну для женщин, другую для мужчин,

17.

[R.Sh.] – Fjalë e nderit?
– **Fjalë e paqes!** – ia priti Hose Arkadio Buendia.
[**Fjalë e paqes!** Shvarci gabon. Duhet **Fjalë armiku**

[M.M.] - Fjalë nderi?
- **Fjalë armiku**, - tha José Arcadio Buendía.
[sp.] -¿Palabra de honor?
-Palabra **de enemigo** -dijo José Arcadio Buendía.
[gj.] »Ehrenwort?« **»Feindeswort«**, sagte José Arcadio Buendía.
[ang.] “Your word of honor?”
“The word of **your enemy**,” José Arcadio Buendía said.
[fr.] — Parole d’honneur ?
— Parole d’**ennemi**, répondit José Arcadio Buendia.
[it.] “Parola d’onore?”
“Parola **di nemico**,” disse José Arcadio Buendia.
[rus.] — Слово чести?
- Слово врага, — сказал Хосе Аркадио Буэндиа.

18.

[R.Sh.] Ishte i pari dhe **më i përzishmi** varrim që **përjetoi** fshati dhe, vetëm një shekull më vonë, ia kaloi **për nga madhështia varrimi i Kufomës së Mamasë së Madhe** gjatë **kremtimit të karnavaleve**.
[Ja një gafë e Shvarcit: **varrimi i Kufomës së Mamasë së Madhe. Është karnavali mortor i Nënëmadhes. Pastaj, ç’kuptim ka përdorimi shkronjës së madhe në nisje të fjalës Kufomë?**]

[M.M.] Ishte varrimi i parë dhe **më i bujshmi** që u pa në fshat, të cilit ia kaloi, pothuaj një shekull më vonë, **karnavali mortor i Nënëmadhes**.
[sp.] Fue el primer entierro y el más concurrido que se vio en el pueblo, superado apenas un siglo después por el carnaval funerario de la Mamá Grande.
[gj.] Es war das erste und meistbetrauerte Begräbnis, welches das Dorf erlebte, und wurde ein Jahrhundert später nur noch von der Karnevalsleichenbestattung der Großen Mama übertroffen.
[ang.] It was the first burial and the **best-attended** one that was ever seen in the town, only surpassed, a century later, by Big Mama’s funeral carnival.
[fr.] Ce furent les premières obsèques,suivies par la

foule la plus nombreuse, que l’on vit au village, à peine surpassées un siècleplus tard par le carnaval funèbre de la Mamá Grande.
[it.] Fu il primo funerale e con il più grande concorso di persone che si vide nel villaggio, superato appena un secolo dopo dal carnevale funerario della Mamà Grande.
[rus.] Это были первые и самые многолюдные похороны в городе, их превзойдет, и то с трудом, лишь погребальный карнавал, которым столетие спустя почтят память Большой Мамы.

19.

[R.Sh.] ... për ta penguar martesën e së motrës, edhe sikur të detyrohej të shtrihej si kufomë te pragu i portës!
[M.M.] ...që t’ia prishte dasmën së motrës edhe sikur t’i duhej të shtrinte kufomën e saj në prag të derës.

20.

[R.Sh.] Edhe sikur të më degdisin në fund të botës, do t’i gjej mjetet dhe rrugët për ta prishur martesën, **qoftë edhe në u detyrofsha të vras veten!**
[M.M.] Në fund të botës të më çojnë, do ta gjej mënyrën dhe nuk të lë të martohesh, **edhe po të më duhet të të vras**.
[*Sikundër mund të lexohet, është krejt e kundërta e përkthimit të Shvarcit!*]

[sp.] Aunque me lleven al fin del mundo encontraré la manera de impedir que te cases, así tenga que matarte.
[gj.] Auch wenn man mich bis ans Ende der Welt schleppt, werde ich Mittel und Wege finden, deine Ehe zu vereiteln, und müßte ich dich dafür umbringen.
[ang.] Even if they send me to the ends of the earth I’ll find some way of stopping you from getting married, even if I have to kill you.”
[fr.] M’emmènerait-on au bout du monde, je trouverais toujours moyen d’empêcher ton mariage, même s’il me faut te tuer.
[it.] Anche se mi porteranno in capo al mondo troverò il modo di impedire che ti sposi, dovessi ucciderti.”
[rus.] Пусть меня хоть на край света увезут, все равно я сумею расстроить твою свадьбу, я не остановлюсь и перед тем, чтобы убить тебя

21.

[R.Sh.] – Kam për të të thënë, që ti je i prerë për luftë, – iu përgjigj ajo. – **Ngado që hedh sytë ti, hedh edhe plumbin**.
[– **Ngado që hedh sytë ti, hedh edhe plumbin**. *Nuk ka asnjë kuptim!*]

[M.M.] - Doja të të thosha se je i mirë për luftë, - i tha. - **Kur merr shenjë, s’të shkon plumbi bosh**.
[sp.] -Que eres bueno para la guerra -dijo-. Donde pones el ojo pones el plomo.
[gj.] Daß du gut für den Krieg bist«, sagte sie. »Wo hin du das Auge setzt, setzt du das Blei.«
[ang.] “That you’d be good in a war,” she said. “Where you put your eye, you put your bullet.”
[fr.] — Il y a que tu es bon pour la guerre, lui dit-elle. Où tu vises, tu mets dans le mille...
[it.] -”Che sei buono per la guerra,” disse. “Dove metti l’occhio metti il piombo.”
[rus.] — Ты создан для войны, — ответила она. - Куда метишь, туда и попадешь.

22.

[R.Sh.] **I thanë** se kishin jetuar vite me radhë **pa popër**, [pop-prift ortodoks] se për punërat e shpirtit ishin marrë vesh drejtpërdrejt me Zotin dhe se nuk u **mbushej mendja që Adami dhe Eva na paskeshin** mëkatuar aq ligisht...

[**I thanë** se kishin jetuar vite me radhë **pa popër**, Pop quhej dikur prifti ortodoks. *Në vendet Latino Amerikane janë katolikë!*]

[M.M.] I përgjigjeshin se për shumë vjet kishin qenë pa prift, i kishin rregulluar punët e shpirtit drejtpërdrejt me Zotin dhe **ishin çliruar nga ligësia e mëkatit vdekjeprurës**.
[sp.] Le contestaban que durante muchos años habían estado sin cura, arreglando negocios del alma directamente con Dios, y habían perdido la malicia del pecado mortal.
[gj.] Man **erwiderte** ihm, man habe viele Jahre hindurch ohne **Priester** gelebt, habe die Geschäfte der Seele unmittelbar mit Gott verhandelt und habe die Bosheit der Todsünde verloren.
[ang.] They would answer him that they had been many years without a priest, arranging the business of their souls directly with God, and that they **had lost the evil of original sin**.
[fr.] Il s’entendait répondre que, pendant des années et des années, les gens étaient demeurés sans curé, réglant les affaires de l’âme directement avec Dieu, et ne se sentaient plus concernés par la malignité du péché mortel.
[it.] Gli rispondevano che erano rimasti senza prete per molti anni, che sistemavano le faccende dell’anima direttamente con Dio, e che avevano perso la malizia del peccato mortale.
[rus.] Ему отвечали, что много лет прекрасно обходятся без священника и улаживают все вопросы спасения души непосредственно с самим Богом, да и смертных грехов не совершают.

23.

[*R.Sh.*]- *Hoc est simplicissimum*, – u dëgjua zëri i Hose Arkadio Buendias, – *homo iste statum quartum materiae invenit*.1
Patër Nikanori ngriti dorën dhe, menjëherë, të katër këmbëte fronit zbarkuan mbi tokë.
– *Nego*, – ia bëri ai. – *Factum hoc existentiam Dei probat sinedubio!*2
1) (lat): “Kjo është fare e thjeshtë. Njeriu ishte krijuar nga materja e katërt.”
2) (lat): “S’është ashtu. Prova e ekzistencës së Zotit është vërtetuar pa pikën e dyshimit”.
[*Sikundër shihet, nga latinishtja janë përkthyer gabim këto shënime. në përkthimin e Shvarcit.*]

[M.M.]- *Hoc est simplicissimum*, - tha José Arcadio Buendía. - *Homo iste statum quartum materiae invenit*.
Atë Nicanor-i ngriti dorën dhe të katër këmbët e karriges u ulën njëherësh në tokë.
- *Nego*, - tha. - *Factum hoc existeniam Dei probat sine dubio*.
S’ka gjë më të thjeshtë. Njeriu e ka shpikur gjendjen e katërt të lëndës. (lat.)
E mohoj. Është, pa dyshim, provë e ekzistencës së Zotit. (lat.)

24.

[R.Sh.] Kështu ajo filloi ta kërkonte praninë e tij duke sajuar gjithëfarësoj shkaqesh. Njëherë, Hose Arkadioja ia nguli sytë trupit të saj me një vëmendje të paturpshme dhe i tha: – **Je një alamet cope, motërzë!**
[– **Je një alamet cope, motërzë!** *T’ingëllon shumë vullare kjo fjali e përkthyer nga Shvarci!*]

[M.M.] Një herë, José Arcadio-ja ia nguli sytë turpit të saj me një vëmendje të pacipë dhe i tha: **“Je femër nga koka te këmbët, motërzë.”**
[sp.] En cierta ocasión José Arcadio la miró el cuerpo con una atención descarada, y le dijo: «Eres muy mujer, hermanita.»
[gj.] Einmal betrachtete José Arcadio ihren Körper-

er mit schamloser Aufmerksamkeit und sagte: »Bist ein Mordsweib, Schwesterchen.

[ang.] On a certain occasion José Arcadio looked at her body with shameless attention and said to her “You’re a woman, little sister.”

[fr.] Un jour, José Arcadio la détailla avec attention, sans aucune pudeur, et lui dit : « Te voilà une vraie femme, petite soeur. »

[it.] Una volta José Arcadio le guardò il corpo con una sfacciata curiosità, e le disse: “Sei molto donna, sorellina.”

[rus.] Под разными предлогами она искала встречи с ним. Как-то раз Хосе Аркадио с бесстыдным вниманием оглядел ее тело и сказал: «Ты стала совсем женщиной, сестренка».

25.

[R. SH.] Qysh në gjashtë të mbrëmjes mejhanet mbylleshin me urdhër.

[Ja një gafë e pafalshme: ngatërrohet fjala **mejhan** me **shtettrrethimin!** *Në gjermanisht: Zapfenstreich do të thotë Ndalimqarkullim*]

[M. M.] **U vendos shtettrrethimi në orën gjashtë të mbrëmjes.**

[sp.] Se impuso el toque de queda a las seis de la tarde.

[gj.] Um sechs Uhr abends war **Zapfenstreich**.

[angl.] A 6 P.M. **curfew** was established.

[fr.] **Lecouvre-feu** fut fixé à six heures de l’après-midi.

[it.] Si impose **il coprifuoco** alle sei del pomeriggio.

[rus.] Шесть часов вечера объявили **комендантским часом**.

26.

[R.Sh.] Vendimet i merrte një kapiten i ushtrisë, i cili çdo mëngjes lëshonte një qarkore të veçantë për ruajtjen e rendit publik.

[M.M.] Vendimet i merrte një kapiten i ushtrisë, i cili çdo mëngjes mblidhte shtëpi më shtëpi një tagër të jashtëzakonshëm për mbrojtjen e rendit publik.

27.

R. Sh. – Rrini urtë dhe mos bëni as gëk as mëk zoti vjehërr, - e këshilloi. (f. 104)

[Shumë fjalë të tepërta që ndryshojnë krejt kontekstin e dialogut.]

M.M. “Ju rrini i qetë, vjehërr”, - i tha. –

[sp.] «Usted se queda tranquilo, suegro -le dijo-.

[gj.] »Verhalten Sie sich ruhig, Herr Schwiegervater«, riet er ihm. »

[angl.] “Rest easy, father-in-law,” he told him. “

[fr.] Beau-père, vous allez rester tranquille, lui dit-il.

[it.] “Lei può rimanere tranquillo, suocero,” gli disse.

[rus.] «Не волнуйтесь, тесть, — сказал он.

28.

[R.Sh.] Ti nuk e merr dot me mend, se me ç’kënaqësi do të ta plotësoja dëshirën, **por kam Zotin shahit që nuk mundem, nuk mundem!**

[**kam Zotin shahit!** *na dubet fjalori turqisht-shqip për ta kuptuar.*]

[M.M.] “Nuk e merr dot me mend se sa do doja të të kënaqja, **por kam Zotin dëshmitar që nuk mundem**”.

[sp.] No te imaginas cómo quisiera complacerte, pero Dios es testigo que no puedo.»

[gj.] Du kannst dir nicht vorstellen, wie gerne ich dir zu Willen wäre, aber Gott ist mein Zeuge, daß ich nicht kann.

[ang.] “You can’t imagine how much I would like to make you happy, but as God is my witness I can’t.”

[fr.] Tu ne peux imaginer à quel point je voudrais te faire plaisir, mais Dieu m’est témoin que je ne peux pas. »

[it.] Non ti immagini come vorrei accontentarti, ma Dio è testimone che non posso.”

[rus.] Ты даже не знаешь, как мне хотелось бы доставить тебе удовольствие, но, Бог свидетель, не могу».

29.

[R.Sh.] Një natë **të mbushur plot e përplot me ndjenjën** e pasigurisë, kur e vuri re Pilar Terneren në oborrin e brendshëm tek **ia kishte marrë këngës bashkë** me ushtarët, **e thirri në dhomë dhe** iu lut që t’i hidhte fall me letra .

[*Shikoni se sa është zgjeruar kjo fjali: mbi tri herë më shumë germa.*]

[M.M.] **Një natë pasigurie** kur Pilar Ternera këndonte në patio me ushtarët, ai i kërkoi t’i hidhte fall me letra.

[sp.] Una noche de incertidumbre en que Pilar Ternera cantaba en el patio con la tropa, él pidió que le levara el porvenir en las barajas.

[gj.] In einer Nacht der Ungewißheit, als Pilar Ternera im Innenhof mit der Truppe sang, bat er, sie möge ihm die Zukunft aus den Karten lesen.

[ang.] One night of uncertainty, when Pilar Ternera was singing in the courtyard with the soldiers, he asked her to read the future in her cards.

[fr.] Par une nuit d’incertitude, alors que Pilar Ternera chantait dans le patio avec la troupe, il demanda qu’elle vint lui lire l’avenir dans les cartes.

[it.] In una notte d’incertezza, mentre Pilar Tenera cantava nel patio con la truppa, le chiese di leggergli l’avvenire nelle carte.

[rus.] В одну такую полную сомнений ночь, услышав голос Пилар Тернеры, распевавшей во дворе с солдатами, он попросил ее погадать.

30.

[R.Sh.] Porse kur erdhi dita që u bë i vetëdijshtëm edhe **për lakuriqësinë e vet,**

[Është ngatërruar gjinia e personazhit. Duhet **për lakuriqësinë e saj.** Çuditërisht, edhe variantet **gjermanisht** dhe **anglisht** e kanë këtë ngatërresë. Ndaj s'mund ta qortojmë përkthimin e gabuar të Shvarcit.]

[M.M.] Por që ditën që u bë i ndërgjegjshëm **për lakuriqësinë e saj,**

[sp.] Pero desde el día en que tuvo conciencia de **su desnudez,**

[gj.] Doch seit dem Tag, an dem er sich seiner Nacktheit bewußt wurde,

[ang.] But since that day when he became aware **of his own nakedness,**

[fr.] Mais, à partir du jour où il fut conscient de sa nudité,

[it.] Ma dal giorno in cui aveva avuto coscienza **della sua nudità,**

[rus.] Но после того дня, когда он обратил внимание **на ее нагое тело,**

31.

[R.Sh.] ...me disa përpjekje të inatosura të fantazisë së tij,

[M.M.] ...me anë të përpjekjeve të ankthshme të imagjinatës.

[sp.] ... mediante ansiosos esfuerzos de imaginación.

[gj.] Er tröstete sich für seine jäh gefühlte Einsamkeit, seine frühreife Jugend mit nach verdorrten Blumen riechenden Dirnen, die er im Dunkeln idealisierte und mit den wütenden Anstrengungen seiner Phantasie in Amaranta verwandelte.

[ang.] ... by means of the anxious efforts of his imagination.

[fr.] ...moyennant de terribles efforts d’imagination.

[it.] ... con affannosi sforzi de ll’immaginazione.

[rus.] ... страстными усилиями воображения

32.

[R.Sh.] martua me hallën e vet, të cilën, përpos kësaj, qëlloi ta kishte edhe kushërirë **dhe i biri i së cilës u bë gjyshi i tij.-**

[**dhe i biri i së cilës u bë gjyshi i tij.** *Edhe këtu Shvarci ka ngatërruar gjininë e personazhit.*]

[M.M.] ... e cila ishte edhe kushërira e tij, **djali i të cilit arriti të ishte gjyshi i vetvetes.**

[sp.] ... que además era su prima y cuyo hijo terminó siendo abuelo de sí mismo.

[gj.] der seine eigene Tante heiratete, die überdies seine Kusine war und deren Sohn sein eigener Großvater wurde.

[ang.] who was also his cousin, and whose son ended up being his own grandfather.

[fr.] l’homme qui avait épousé une de ses tantes qui, de plus, était sa cousine, et dont le fils finit par se retrouver son propre grand-père.

[it.] era sposato con una zia che era per di più anche sua cugina, e il cui figlio aveva finito per essere nonno di se stesso.

[rus.] которая приходилась ему еще и двоюродной сестрой, и сын его оказался самому себе дедушкой.

33.

[R.Sh.] ... saqë shikimi nuk iu ngul as mbi Remedios Bukuroshen **që bridhte nëpër shtëpi gjysmëlakuriq.**

[Lakuriq dhe jo gjysmëlakuriq. Dhe folja është kohën e kryer, veprimi nuk përsëritet më.]

[M.M.] ... nuk dalloi madje as Remedios bukuroshen **që kaloi lakuriq për te dhoma e gjumit**

[sp.] ... ni siquiera se fijó en Remedios, la bella, que pasó desnuda hacia el dormitorio.

[gj.] ... daß sein Blick nicht einmal auf Remedios der Schönen haftenblieb, die nackt ins Schlafzimmer ging.

[ang.]...that he did not even notice Remedios the Beauty as she passed by naked on her way to her bedroom.

[fr.] ... ne remarqua même pas Remedios-labelle qui se dirigeait toute nue vers sa chambre.

[it.] Sembrava cos ì estraneo a tutto che non badò nemmeno a Remedios la bella, che nuda passò diretta verso la stanza da letto.

[rus.] ... не обратил внимания на Ремедиос Прекрасную, которая прошла мимо столовой совершенно голая.

34.

[R.Sh.] Kremtimi u organizua nga njëzet kilometra larg Makondos, **nën hijen e një peme vigane pam-buku, ...**

[Pambuku nuk është **pemë**, për më tepër **vigane**. Pambuku është një bimë industriale!]

[M.M.] Ceremonia u kremtua njëzet kilometra larg Macondo-s, nën hijen **e një ceibe gjigante, ...**

[sp.] El acto se celebró a veinte kilómetros de Macondo, a la sombra de una **ceiba gigantesca ...**

[gj.] Die Feier fand zwanzig Kilometer von Macondo statt, im Schatten eines **gewaltigen Baumwollbaums,**

[ang.]The ceremony took place fifteen miles from Macondo in the shade of a **gigantic ceiba tree**

[fr.] La cérémonie eut lieu à une vingtaine de kilomètres de Macondo, à l’ombre d’un arbre à **kapok gigantesque,**

[it.] La cerimonia ebbe luogo a venti chilometri da Macondo, all'ombra di una **ceiba gigantesca**
[rus.] Церемония состоялась в двадцати километрах от Макондо под **гигантской сейбой**,

35.

[R.Sh.] .një grup rishtaresh manastiri, të veshura me të bardha dhe fort të emocionuara, të cilat ngjanin me një trumbë **dallëndyshesh** të trembura nga shiu.
[*Dallëndyshet janë zogj të vegjël me shpinë të zezë të stolisur në blu, fyt në ngjyrën e “ndryshkut”, bark të bardhë dhe bisht të gjatë.*]

[M.M.] ... nga një grup rishtaresh gazmore me veshje të bardha, që ngjanin si një trumbë **pëllumbe-shash** të trembura nga shiu.
[sp.] ... grupo de novicias de hábitos blancos, que parecían un revuelo de palomas asustadas por la lluvia.
[gj.] ... weißgekleideter Novizinnen bedient, die einem Schwarm von regenverscheuchten Schwalben glichen.
[ang.]... group of novices in white habits who looked like a flock of doves that had been frightened by the rain.
[fr.] par un groupe de sémillantes novices en habits blancs qui ressemblaient à un envol de colombes effarouchées par la pluie.
[it.] ... gruppo di novizie in abito bianco, che sembrava uno stormo di colombe spaventate dalla pioggia.
[rus.] ... гурьба послушниц в белых одеждах, напоминавшая потревоженную дождем голубиную стаю.

36.

[R.Sh.] **Mbante të njëjtin kaftan anakronik** dhe kapelen strehëgjere si pendë korbi;
[*kaftani Rrobë e gjatë zakonisht prej mëndafshi dhe e stolisur, që mbanin zyrtarët e lartë turq.*]

[M.M.] Mbante të njëjtin **jelek anakronik**, kapelën me flatra korbi
[...nga kërthiza e saj një haraç shumë të madh, **përkthen Shvarci**. *Në fakt nuk bëhet fjalë as për kërthizë, as për haraç!*]

[M.M.] dhe u gjend papritur me një burrë, fuqia e llahtarshme e të cilit ngulmoi që rropullitë e saj t'i përgjigjeshin me një **lëvizje sizmike**.

[sp.] y se encontró de pronto con un hombre cuyo poder tremendo exigió a sus entrañas un movimiento de reacomodación sísmica.

[gj.] hatte aber alsbald einen Mann vor sich, dessen unheimliches Vermögen von ihren Eingeweiden eine erdbebenhafte Anpassung forderte.

[ang.] and suddenly it found a man whose tremendous power demanded a movement of seismic readjustment from her insides.

[fr.] et qui se trouva tout à coup devant un homme dont l'extraordinaire vigueur exigea de ses entrailles un mouvement de réacommodation sismique.

[it.] e si trovò improvvisamente con un uomo il cui tremendo potere richiese alle sue viscere un moto di riassetamento sismico.

[rus.] Она приготовилась отделаться от Аурелиано, как от испуганного ребенка, но очень скоро

обнаружила, что имеет дело с мужчиной, чья чудовищная мощь всколыхнула все ее чрево, как землетрясение.

83.

[R.Sh.] ... përfundoi me një diskutim në shtëpinë **e vajzave të vogla që të futeshin në shtrat nga uria**, në një bordel të rremë në kufi të Makondos.

[...e vajzave të vogla që të futeshin në shtrat nga uria, *thotë Shvarc*. *Në shtrat mund të futesh edhe për të fjetër gjumë. Ndërsa këtu bëhet fjalë, për e vajzave të vogla që jepeshin për bukën e gojës,...*]

[M.M.]...përfundoi në shtëpinë **e vajzave të vogla që jepeshin për bukën e gojës**, një bordello e gënjeshtërt në periferinë e Macondo-s.

[sp.] ... terminó en la casa de las muchachitas que se acostaban por hambre, un burdel de mentiras en los arrabales de Macondo.

[angl.] ... ended up in the house of the girls who went to bed because of hunger, a brothel of lies on the outskirts of Macondo.

[fr.]... se termina dans cette maison appelée Aux gamines qui font l'amour pour manger, bordel de faux-semblants dans les faubourgs de Macondo.

[it.]...terminò nella casa delle ragazzine che facevano all'amore per fame, un bordello da finzione nei sobborghi di Macondo.

[rus.]...закончилась у девушек, торговавших собой с голодухи, в призрачном борделе одного из предместий Макондо.

[R.Sh.]Në të vërtetë, Hose Arkadioja, qyshse i kishte dëbuar djemtë nga shtëpia, po priste lajme për një vapor transoceanik i cili qe nisur për në Napoli qysh nga Krishtlindjet e shkuara.

[M.M.]Në të vërtetë, që kur i përzuri fëmijët nga shtëpia, José Arcadio-ja priste lajme nga një transatlantik që do të nisej për në Napoli përpara krishtlindjeve.

[sp.] En realidad, desde que expulsó a los niños de la casa, José Arcadio esperaba noticias de un trasatlántico que saliera para Nápoles antes de Navidad.

[gj.] In Wirklichkeit wartete José Arcadio seit der Vertreibung der Knaben aus dem Haus auf Nachrichten von einem Überseedampfer, der vor Weihnachten nach Neapel ausgelaufen war.

[angl.]Ever since he had expelled the children from the house, José Arcadio was really waiting for news of an ocean liner that would leave for Naples before Christmas.

[fr.] En réalité, depuis qu'il avait chassé les enfants de la maison, José Arcadio attendait des nouvelles d'un transatlantique qui devait partir pour Naples avant Noël.

[it.] In realtà, da quando aveva scacciato i bambini di casa, José Arcadio aspettava notizie di un transatlantico che partisse per Napoli prima di Natale.

[rus.] С тех пор как Хосе Аркадио выгнал мальчиков из дома, он жил в ожидании известий о трансатлантическом лайнере, на котором должен был отправиться в Неаполь еще до Рождества.

84.

[R.Sh.] **Ndërsa ngjishte njërën puthje pas tjetrës mbi pëllëmbën e dorës së plagosur si ndonjë jetim gjynahqar**, i hapi kanalet më të fshehta të zemrës dhe nxori që andej **një shirit të qulltë e të pafund**, atë **krimbin parazit të neveritshëm**, që e kishte krijuar vetë gjatë makthit të tij torturues.

[**krimbin parazit të neveritshëm. Duhet: kafshën e tmerrshme parazitare**]

[M.M.] Duke e mbuluar me të **puthura të vockla jetime** pëllëmbën e dorës së plagosur, hapi shtigjet më të fshehta të zemrës së tij, dhe nxori rropullitë e pafundme dhe të marinuara, **kafshën e tmerrshme parazitare** që kish krijuar vetë gjatë vuajtjes së tij sflitëse

[sp.] Dándole besitos huérfanos en el cuenco de la mano herida, abrió los pasadizos más recónditos de su corazón, y se sacó una tripa interminable y macerada, el terrible animal parasitario que había incubado en el martirio.

[gj.] Während er in die verletzte Handfläche Waisenküßchen drückte, öffnete er die geheimsten Kanäle seines Herzens und zog einen endlosen zermürbten Bandwurm hervor, jenes schreckliche Schmarotzertier, das er im Martyrium ausgebrütet hatte.

[ang.] Giving her some small, orphaned kisses in the hollow of her wounded hand, he opened up the most hidden passageways of his heart and drew out an interminable and lacerated intestine, the terrible parasitic animal that had incubated in his martyrdom.

[fr.] Tout en déposant des petits baisers orphelins dans le creux de sa main blessée, il ouvrit les orifices les plus secrets de son coeur et laissa sortir une interminable tripaille en décomposition, le terrible animal parasite qu'il avait couvé durant son martyre.

[it.] Dandole bacetti orfani nel cavo della mano ferita, aprì gli anditi più occulti del suo cuore, e ne tolse un viscere interminabile e macerato, il terribile animale parassitario che aveva incubato nel martirio.

[rus.] Осыпая беспомощными поцелуями ладошку раненой руки, он открыл самые потаенные уголки своего сердца и извлек оттуда нескончаемо длинного, разбухшего червя, страшного паразита, вскормленного его страданиями.

85.

[R.Sh.] në bregun e përtejme të lumit Orinoko, pasi rojet e kufirit i dhanë një purgativ dhe e vunë pastaj mbi një uturak, që u mbush sakaq **me mut diamantesh**.

[që u mbush sakaq **me mut diamantesh. Shumë vulgare!**]

[M.M.] që ishte në burg në bregun tjetër të Orinoco-s, sepse rojet e kufirit i kishin dhënë purgativ dhe e kishin ulur pastaj në një uturak **që u mbush me të pëgëra me diamante**.

[sp.] estaba preso al otro lado del Orinoco, porque los guardias fronterizos lo habían purgado y lo habían sentado luego en una bacinilla que quedó llena de mierda con diamantes.

[gj.] der auf dem anderen Ufer des Orinoco verhaftet worden war, weil die Grenzwächter ihm einen Einlauf verabreicht und ihn anschließend auf einen Nachttopf gesetzt hatten, der vollief mit Diamantenscheiße.

[ang.] on the other side of the Orinoco because the border guards had caught him and had made him sit on a chamberpot that filled up with a mixture of shit and diamonds.

[fr.] sur l'autre rive de l'Orénoque, parce que les garde-frontières lui avaient donné une purge et l'avaient fait asseoir sur un pot de chambre qu'il laissa plein de merde avec des diamants.

[it.] dall'altra parte dell'Orinoco, perché le guardie di frontiera lo avevano purgato e poi lo avevano fatto sedere su un pitale che si era riempito di merda con diamanti.

[rus.] отбывавшего срок в тюрьме по ту сторону Ориноко, потому что пограничники напоили его слабительным и посадили на горшок, и потом в горшке оказалось полно бриллиантов.

86.

[R.Sh.] ..., **të cilit dhisnin diamante, ose kullufiteshin nga kanibalët, ose ishin mbretër prej letre, të kurorëzuar nëpër ca anije të stisura që gjoja çanin detrat e rruzullit**.

[...**dhisnin diamante- shumë vulgare. kullufiteshin nga kanibalët- Duhet hanin kanibalë**]

[M.M.] ..., **që jashtëqitnin diamante ose hanin kanibalë**, apo kurorëzoheshin mbretër të letrave të bixhozit në det të hapur.

[sp.] ..., que cagaban diamantes, o se comían a los caníbales, o eran coronados reyes de barajas en altamar.

[gj.] ..., die Diamanten schissen oder Kannibalen fraßen oder auf hoher See gekrönte Kartenkönige waren.

[angl.] ..., who shat diamonds, or ate cannibals, or were crowned playing-card kings on the high

seas.

[fr.]..., qui chiaient des diamants, ou mangeaient des cannibales, ou se faisaient couronner rois de jeu de cartes en haute mer.

[it. ... che cagavano diamanti, o che si mangiavano i cannibali, o che erano incoronati re di coppe in altomare.

[Rus.]...испражнялись бриллиантами, пожирали друг друга, наподобие каннибалов, или были коронованными карточными королями, скитающимися по морям.

87.

[R.Sh.] Por, me atë mbrojtjen e zjarrtë dhe nderimin që i bënte dhe që tregonte ndaj fjalës së shkruar, te plaku katalonas përzihej **edhe njëlloj prirjeje për t'u marrë me thashetheme pak si rrugaçe**.

[...**thashetheme pak si rrugaçe. Çdo të thotë kjo?**]

[M.M.] Adhurimi i tij për fjalën e shkruar ishte një përzierje e respektit solemn me thashethemet dhe mungesën e respektit.

[sp.] Su fervor por la palabra escrita era una urdimbre de respeto solemne e irreverencia comadrera.

[angl.] His fervor for the written word was an interweaving of solemn respect and gossipy irreverence.

[fr.] Dans sa ferveur pour le discours écrit s'entre-croisaient un solennel respect et la désinvolture des faiseurs de commérages.

[it.] Il suo fervore per la parola scritta era una mescolanza di rispetto solenne e di irriverenza pettegola.

[rus.] Горячая любовь ученого каталонца к печатному слову являла собой смесь глубокого уважения и панибратской непочтительности.

88.

[R.Sh.] **Ai ishte i vetmi i mbijetuar i një të kaluare**, shkatërrimi i së cilës nuk përmbushej deri në fund, sepse po shkatërrohej pafundësisht, po brehej brenda vetes, po ndërpritej çdo minutë, por pa u ndërprerë, pa u ndalur kurrë.

[*Ja një gafë tjetër: Bëhet fjalë për një farmaci, Shvarci e merr për një personazh mashkull. Ai ishte i vetmi i mbijetuar i një të kaluare, ...*]

[M.M.] **Ishte e fundit që kish mbetur nga një e kaluar**, shkatërrimi i së cilës nuk po përfundonte, sepse vazhdonte të shkatërrohej pafundësisht brenda vetes, duke mbaruar në çdo minutë, por pa mbaruar së mbaruari kurrë.

[sp.]Eralo último que iba quedando de un pasado cuyo aniquilamiento no se consumaba, porque seguía aniquilándose indefinidamente, consumiéndose dentro de sí mismo, acabándose a cada minuto pero sin acabar de acabarse jamás.

[gj.]Er war der einzige Überlebende einer Vergangenheit, deren Vernichtung sich nicht vollzog, weil sie sich endlos vernichtete, in sich selbst verzehrte, in jeder Minute aufhörte, doch ohne aufzuhören, jemals aufzuhören.

[angl.] It was the last that remained of a past whose annihilation had not taken place because it was still in a process of annihilation, consuming itself from within, ending at every moment but never ending its ending.

[fr.] C'était tout ce qui subsistait d'un passé dont l'anéantissement n'arrivait pas à se consommer, parce qu'il continuait indéfiniment à s'anéantir, se consumant de l'intérieur, finissant à chaque minute mais n'en finissant jamais de finir.

[ital.] Erano le ultime cose che rimanevano di un passato il cui annichilamento non si consumava, perché continuava ad annichilarsi indefinitamente, consumandosi dentro sé stesso, terminandosi in ogni minuto ma senza terminare di terminarsi mai.

[rus.]Только одна эта аптека и осталась в городе от прошлого, разрушение которого все никак не приходило к концу, ибо прошлое разрушалось бесконечно, поглощая само себя, готовое каждое мгновение кончиться совсем, но так никогда и не кончая кончатся.

89.

[R.Sh.] Porse tani, kur mbetën vetëm në shtëpi, iu dorëzuan si të lajthitur **një dehjeje dashurore e cila kërkonte ende shumë, derisa të ngopej mirë**.

[...**kërkonte ende shumë, derisa të ngopej mirë. Shumë e rëndomtë si fjali e përkthyer!**]

[M.M.] Por kur u gjendën vetëm në shtëpi, u lëshuan në delirin e dashurive të vonuara.

[sp.] Pero cuando se vieron solos en la casa sucumbieron en el delirio de los amores atrasados.

[gj.] Als sie sich jedoch allein im Haus sahen, stürzten sie sich in den Taumel einer Liebe, die vieles nachzuholen hatte.

[ang.] But when they saw themselves alone in the house they succumbed to the delirium of lovers who were making up for lost time.

[fr.] Pero cuando se vieron solos en la casa sucumbieron en el delirio de los amores atrasados.

[it.] Ma quando si ritrovarono soli nella casa soccombettero al delirio degli amori arretrati.

[rus.] Оставшись одни, любовники отдались безумию долго смиряемого чувства.

90.

[R.Sh.] Pa i lënë kohë të mbrohej, u hodhën me gjithë rroba në hauzin e banjës, e kapën nga flokët dhe ia zhytën kokën në ujë, derisa llapashitja e përleshjes së tij u fundos në thellësitë kundërmuese. ai zuri ta kërkonte nëpër të gjithë shtëpinë dhe e gjeti më së fundi **duke notuar** nëpër ujrë e pasqyrta të hauzit, të madh e të buhavitur ...

[Në fakt duhet përkthyer -duke pluskuar- sepse Jose Arcadio, i vdekuri, nuk noton, por pluskon.]

[M.M.] Pa i lënë kohë të mbrohej, u futën me rroba

në vaskë, e mbërthyen nga flokët dhe ia mbajtën kokën në ujë, gjersa pushoi në sipërfaqe flluskimi i agonisë, dhe trupi i zbehtë dhe i heshtur prej delfini rrëshqiti në fund të ujërave aromatike. e gjeti duke pluskuar në pasqyrat e parfumuara të vaskës, të stërmadh dhe të fryrë...

[sp.] Sin darle tiempo de defenderse, se metieren vestidos en la alberca, lo agarraron por el pelo y le mantuvieron la cabeza hundida, hasta que cesó en la superficie la borboritación de la agonía, y el silencioso y pálido cuerpo de delfín se deslizó hasta el fondo de las aguas fragantes. Después se llevaron les tres sacos de ere que sólo elles y su víctima sabían dónde estaban escondidos. Fue una acción tan rápida, metódica y brutal, que pareció un asalto de militares. Aureliano, encerrado en su cuarto, no se dio cuenta de nada. Esa tarde, habiéndolo echado de menos en la cocina, buscó a José Arcadio por toda la casa, y lo encontró fletando en les espejos perfumados de la alberca, enorme y tumefacto, y

[gj.] Ohne ihm Zeit zur Verteidigung zu lassen, sprangen sie angezogen in die Zisterne, packten ihn am Haar und drückten seinen Kopf unter Wasser, bis das Gesprudel seines Todeskampfes unter der Oberfläche verebte und der stille bleiche Körper des Thronfolgers in die duftenden Wassertiefen sank. Dann holten sie die drei Säcke mit Gold, deren Versteck nur sie und ihr Opfer kannten. Ihre Aktion war so rasch, methodisch und brutal, daß sie einem militärischen Überfall glich. Der in seiner Kammer eingeschlossene Aureliano merkte nichts. Als er José Arcadio an jenem Nachmittag in der Küche vermißte, suchte er ihn im ganzen Haus und fand ihn in den duftenden Spiegeln der Wanne schwimmen, riesig und gebläht und noch immer an Amaranta denkend. Erst jetzt begriff er, wie sehr er ihn zu lieben begonnen hatte.

[ang.] That afternoon, having missed him in the kitchen, he looked for José Arcadio all over the house and found him floating on the perfumed mirror of the pool, enormous and bloated ...

[fr.] L'après-midi, ne l'ayant pas trouvé à la cuisine, il chercha José Arcadio dans toute la maison et le découvrit flottant dans les miroirs odorants du bassin, énorme, tuméfié, ...

[it.] Senza permettergli di difendersi, saltarono vestiti nella cisterna, lo afferrarono per i capelli e gli tennero la testa affondata, finché cessò sulla superficie il bulicare dell'agonia, e il silenzioso e pallido corpo di delfino scivolò in fondo alle acque fragranti. Poi si portarono via i tre sacchi d'oro il cui nascondiglio conoscevano soltanto loro e la vittima. Fu un'azione così rapida, metodica e brutale, che parve un assalto di militari. Aureliano, chiuso nella sua stanza, non si accorse di nulla. Quel pomeriggio, avendone sentito la mancanza in cucina, cercò José Arcadio per tutta la casa, e lo trovò che galleggiava sugli specchi profumati della cisterna, enorme e tumefatto, e col pensiero ancora rivolto ad Amaranta. Soltanto allora comprese quanto aveva cominciato a volergli bene. Quel pomeriggio, avendone sentito la mancanza in cucina, cercò José Arcadio per tutta la casa, e lo trovò che galleggiava sugli specchi profumati della cisterna, enorme e tumefatto, ...

[rus.] Не дав ему опомниться, они, как были, в одежде, бросились в бассейн, схватили Хосе Аркадио за волосы и держали его голову под водой до тех пор, пока на поверхности не перестали появляться пузырьки воздуха и безмолвное, бледное тело наследника папского престола не опустилось в глубины ароматных вод. Затем они унесли с собой три мешка с золотом, взяв их из тайника, известного только им да их жертве. Вся операция была проведена по-военному быстро, организованно и безжалостно. Аурелиано, сидевший взаперти в своей комнате, ничего не подозревал. Только вечером, придя на кухню, он хватился Хосе Аркадио, стал искать его по всему дому и наконец нашел в купальне. Хосе Аркадио, огромный и распухший, плавал на благоухающей зеркальной поверхности бассейна, все еще думая

об Амаранте. Лишь теперь Аурелиано понял, что успел полюбить его.

91.

[R.Sh.] ... se si veranda po fundosej sërishmi nën **baltovinë**; por ajo shkundej vetëm atëherë, kur i rrezi-kohej dhoma e gjumit.

[baltovina ngatërrohet me llavën.]

[M.M.] ... dhe pa përroin prej **llave** të gjallë që e pushtoi sërish verandën, por u shqetësua që t'i luftonte vetëm kur i gjeti në dhomën e saj të gjumit.

[sp.] ..., y vio el torrente de lava viva apoderándose otra vez del corredor, pero solamente se preocupó de combatirlo cuando lo encontró en su dormitorio.

[gj.]..., sie sah den Gießbach der lebenden Lava von neuem die Veranda begraben, doch sie bekämpfte ihn nur, wenn er in ihr Schlafzimmer einbrach.

[angl.] ... and she watched the torrents of living lava take over the porch again, but she bothered to fight them only when she found them in her bedroom.

[fr.] ..., et vit ce torrent de lave vivante se rendre à nouveau maître de la véranda, mais elle ne se soucia d'en enrayer l'invasion qu'au moment où elle le trouva parvenu jusque dans sa chambre.

[it.] ..., e vide il torrente di lava viva che si impadroniva di nuovo del portico, ma si preoccupò di combatterlo soltanto quando lo trovò nella sua stanza.

[rus.] ..., видела, как их живая лава снова разливается по галерее, но, одурманенная страстью, взялась за их уничтожение лишь после того, как они появились в ее спальне.

92.

[R.Sh.] Mirëpo, ndërsa Amaranta Ursula **vërshtë-lente** e kënaqur njërën melodi pas tjetrës ...

[Përfytyroni një grua që vërshtëllente...]

[M.M.] Veç kësaj, ndërsa ajo **këndonte** nga kënaqësia dhe vdiste duke qeshur me shpikjet e saj...

[sp.] Además, mientras ella cantaba de placer y se moría de risa de sus propias invenciones...

[angl.] And yet, while she was singing with pleasure and dying with laughter over her own inventions, ...

[gj.]Andrerseits, während sie vergnüglich trällerte und sich über ihre eigenen Erfindungen ...

[it.] Inoltre, mentre lei cantava di piacere e moriva di risa per le sue stesse invenzioni, ...

[rus.] В то время как Амаранта Урсула пела от удовольствия и умирала со смеху, ...

93.

[R.Sh.] **Gjatë pushimeve të shkurtra midis delireve voluptuoze**, Amaranta Ursula **ulej dhe u shkruante** përgjigjet letrave të Gastonit.

[**Gjatë pushimeve të shkurtra midis delireve voluptuoze**,... *krejt pa kuptim!*]

[M.M.] **Gjatë pauzave të delirit**, Amaranta Ursula i përgjigjej letrave të Gaston-it.

[sp.] En las pausas del delirio Amaranta Úrsula contestaba las cartas de Gastón.

[gj.] In den Pausen des Taumels beantwortete Amaranta Ursula Gastons Briefe.

[ang.] During the pauses in their delirium, Amaranta Úrsula would answer Gaston's letters.

[fr.] Dans les moments de répit que lui laissait leur délire, Amaranta Ursula répondait aux lettres de Gaston.

[it.] Nelle pause del delirio, Amaranta Ursula rispondeva alle lettere di Gastón.

[rus.] В минуты просветления Амаранта Урсула отвечала на письма Гастона.

94.

[R.Sh.] Gjatë shtatzanisë së saj **shushatëse**, Amaranta Úrsula u mundua të merrej në shtëpi me prodhimin artizanal të gjerdanëve prej **halash peshku**. [*Si mund të bëhen*: gjerdanëve prej **halash peshku**.]

[M.M.] Në përgjumjen e barrës, Amaranta Úrsula u orvat të ngrinte një zeje të prodhimit të varëseve prej **vertebrave të peshqve**.

[sp.] En el sopor del embarazo, Amaranta Úrsula trató de establecer una industria de collares de vértebras de pescados.

[Während ihrer betäubenden Schwangerschaft versuchte Amaranta Ursula eine Heimindustrie von Halsketten aus Fischgräten aufzuziehen.

[fr.] Pendant sa somnolente grossesse, Amaranta Ursula essaya d'organiser une petite industrie de colliers en vertèbres de poissons.

[it.]Nel sopore della gravidanza, Amaranta Ursula cercò di organizzare una industria di collane di vertebre di pesci.

[rus.] Пока тянулась беременность, Амаранта Урсула пыталась наладить производство ожерелий из рыбьих позвонков, но не нашла для них покупателей, кроме Мерседес, которая приобрела себе около дюжины.

95.

[R.Sh.] Alvaroja ishte i pari që vajzën me pulovër të kuqe që pikturonte akuarele në brigjet e liqeneve të Miçiganit dhe që, me pelenat e saj, i çonte një “lamtumirë”, e cila nuk ishte një lamtumirë ndarjeje, por një lamtumirë shprese, sepse ajo nuk e dinte që po ndiqte me sy një tren pa kthim.

[M.M.] Vajzën me pulovër të kuqe që pikturonte akuarele në liqenet e Miçiganit, dhe që i bëri me pelenat një shenjë lamtumire, e cila nuk ishte ndarje, por shpresë, sepse nuk e dinte se po shihte një tren që po ecte pa kthim.

[sp.] la muchacha de suéter rojo que pintaba acuarelas en los lagos de Michigan, y que le hizo con los pinceles un adiós que no era de despedida sino de esperanza, porque ignoraba que estaba viendo pasar un tren sin regreso.

[gj.] das Mädchen im roten Sweater, das an den Seen von Michigan Aquarelle malte und ihm mit ihren Pinseln ein Adieu zuwinkte, das kein Abschieds-, sondern ein Hoffungslebewohl war, weil sie nicht wußte, daß sie einem Zug ohne Wiederkehr nachsah.

[ang.] the girl in the red sweater painting watercolors by a lake in Michigan who waved at him with her brushes, not to say farewell but out oerf hope, because she did not know that she was watching a train with no return passing by.re4

[fr.] les amants grecs dans le crépuscule infernal de l'Arizona, la jeune fille en pull rouge qui peignait des aquarelles sur les lacs du Michigan et qui lui adressa avec ses pinceaux un signe qui n'était pas d'adieu mais d'espérance, parce qu'elle ignorait que le train qu'elle voyait passer était sans retour.

[it.] la ragazza col golfino rosso che dipingeva acquerelli nei laghi del Michigan, e che gli aveva fatto coi pennelli un cenno di addio che non era di commiato ma di speranza, perché ignorava che stava vedendo passare un treno senza ritorno.

[rus.] Альваро первым выполнил совет покинуть девушка в красном свитере, которая писала акварелью окрестности озера Мичиган и помахала Альваро кисточками—в этом приветствии было не прощание, а надежда, ведь девушка не знала, что перед ней поезд, который не возвратится.

96.

[R.Sh.] Të ndërgjegjshëm për këtë kërcënim, Aurelianoja dhe Amaranta Ursula i kaluan muajt e fundit

duke u mbajtur për dore, në pritje të djalit, të foshnjës së ngjizur mes **vorbullës çmendurake të incestit**.

[vorbullës çmendurake të incestit. *Fjala incest nuk është në origjinal!*]

[M.M.] Të ndërgjegjshëm për një kërcënim të tillë, Aureliano-ja dhe Amaranta Úrsula i kaluan muajt e fundit të kapur për dore, duke e përfunduar me dashuri besimtarie fëmijën e nisur me **çmenduri dashurie**.

[sp.] Conscientes de aquella amenaza, Aureliano y Amaranta Úrsula pasaron los últimos meses tomados de la mano, terminando con amores de lealtad el hijo empezado con desafueros de fornicación.

Dieser Bedrohung bewußt, verbrachten Aureliano und Amaranta Ursula die letzten Monate, einander an der Hand haltend und den Sohn, das in der Tollheit der Unzucht begonnene Kind, mit der Liebe der Treue beendend.

[angl.] Aware of that menace, Aureliano and Amaranta Úrsula spent the hot months holding hands, ending with the love of loyalty for the child who had his beginning in the madness of fornication.

[fr.] Conscients d'une pareille menace, Aureliano et Amaranta Ursula passèrent ces derniers mois en se tenant par la main, achevant en d'innocentes amours l'enfant qu'ils avaient commencé dans une fornication effrénée.

[it.] Coscienti di quella minaccia, Aureliano e Amaranta Ursula passarono gli ultimi mesi

con la mano nella mano, terminando con amori di lealtà il figlio iniziato con sfrenatezze di fornicazione.

[rus.] Сознавая эту опасность, Аурелиано и Амаранта Урсула все последние месяцы жили, держа друг друга за руку, донашивая в преданной любви сына, зачатого в безумствах страсти.

97.

[R.Sh.] Dëgjoni Ursulën tek **turfullonte** kundër **ligjeve të Krijimit të Botës**, që e pengonin për ta mbajtur gjallë fisin e saj;

[*Ja një gafë tjetër: ligjeve të Krijimit të Botës...* Bëhet fjalë për **ligjet e krijimit** për të ruajtur brezninë, dhe, për *çfarë arsye, me shkronjë të madhe?!]*

[M.M.] Dëgjuan Ursula-n duke u përleshur me **ligjet e krijimit** për të ruajtur brezninë,

[sp.] Oyeron a Úrsula peleando con las leyes de la creación para preservar la estirpe,

[gj.] Sie hörten Ursula, die gegen die Gesetze der Schöpfung stritt,

[ang.] **They could hear Úrsula fighting against the laws of creation to maintain the line,**

[fr.] Ils entendirent Ursula se battre contre les lois de la création pour préserver sa lignée,

[it.] Udirono Ursula che litigava con le leggi della creazione per preservare la stirpe,

[rus.] Они слышали, как Урсула ведет битву с законами творения, чтобы сохранить свой род,

98.

[R.Sh.] ... Profili i saj u bë më **hirplotë**, e kuqja e fytyrës ia lëshoi vendin një ngjyrë alabastrit në të trëndafiltë, dhe përmbi tiparet iu nder rishitazi një buzëqeshje.

[*Bëhet fjalë për një njeri që po vdes. Ndaj profili s'mund të bëhet më hirplotë*]

[M.M.] ..., profili iu **hollua**, njollëzat e përkuqura të fytyrës iu tretën në një agim alabastrit dhe buzëqeshi sërisht.

[sp.] ... y se le afiló el perfil, y los verdugones de la cara se le desvanecieron en una aurora de alabastro, y volvió a sonreír.

[gj.] ... Ihr Profil wurde feiner, und die Röte ihres Gesichts wich einer alabasterfarbenen Morgenröte, und sie lächelte von neuem.



[angl.] ... her profile became sharp and the blotches on her face evaporated in a halo of alabaster and she smiled again.

[fr.] ..., son profil devenir effilé, les rougeurs de son visage s'évanouir en une aurore d'albâtre et qu'elle se mit de nouveau à sourire.

[it.] ... e le si affilò il profilo, e le lividure della faccia le si dissolsero in un'aurora di alabastro, e tornò a sorridere.

[rus.] ... кровавый ручей иссяк сам собой, профиль заострился, выражение муки исчезло в разлившемся по лицу алебастровом сиянии, на губах снова появилась улыбка.

99.

[R.Sh.] Me të sosur në shtëpi, u sul te shporta – por foshnja nuk ndodhej aty.

[*Dyfishi i germave në këtë fjalë të thjeshtë*]

[M.M.] Nuk e gjeti në shportëz.

[sp.] No lo encontró en la canastilla.

[gj.] Er fand ihn nicht im Korb.

[angl.] He could not find the basket.

[fr.] Il ne le trouva pas dans la corbeille.

[it.] Non lo trovò nel cestino.

[rus.] В корзине младенца не было.

100.

[R.Sh.] ... Ursula ishte **ringjallur nga vdekja** që të përkujdesej për fëmijën.

[*...ringjallur nga vdekja, nuk bëhet fjalë për Jezu Krishtin!*]

[M.M.] ... Úrsula ishte **zgjuar nga vdekja** për t'u marrë me fëmijën.

[sp.] ... Amaranta Úrsula había despertado de la muerte para ocuparse del niño.

[gj.] ... Ursula sei vom Tode erwacht, um das Kind zu umhegen.

[angl.] ... Ursula had awakened from death to take care of the child.

[fr.] ... Ursula s'était réveillée de la mort pour s'occuper du bébé.

[it.] ... Ursula si fosse svegliata dalla morte per occuparsi del bambino.

[rus.] ... пробудилась от смерти, чтобы заняться сыном.



Përfundimi i këtij shkrimi të gjatë, të jem i singertë, më shumë më jep trishtim sesa gëzim. E di mirë përse më ndodh kjo. Ka plot njëzet vjet që e kam konstatuar nivelin e përkthimit të këtij libri nga Robert Shvarc. Ka qenë diçka që e kam mbajtur për vete dhe kurrë nuk kam dashur të bëj show me këtë fakt. Sepse e di mirë që Robert Shvarc është një figurë e dashur për shqiptarët, mijëra lexues e kanë ngulitur në kujtesën e tyre të viteve të adoleshencës dhe të rinisë. Unë vetë, si botues, kam nderimin më të madh për Shvarcin dhe të gjithë përkthyesit e tjerë, këta heronj të një lufte të pabarabartë. Ndërkohë, ndërgjegjja ime profesionale më bën të jem në krahun e lexuesit, gjë të cilën e kam nisur që në vitin e largët 1992.

Ndërkohë, nuk mund të mos shpreh nderimin tim për një përkthyes të klasit të parë si Mira Meksi. Duke e kontrolluar çdo fjalë të romanit “Njëqind vjet vetmi” me gjashtë gjuhë të huaja, mund të them me bindjen më të plotë se përkthimi i Mira Meksit në shqip është, pa dyshim, më i sakti, më korrekti, më besniku nga të gjitha përkthimet në këto gjuhë të huaja. Me një përvojë të jashtëzakonshme, tridhjetë vjet pas përkthimit të romanit tjetër të Markezit, “Dashuria në kohërat e kolerës”, Mira Meksi u ka dhuruar lexuesve një përkthim të cilin, edhe për njëqind vjet, s’besoj se do ta rivalizojë kush.



POEZITË E BURGUT

Nga Visar Zhiti

ARDHJA E PEGASIT NË QELINË TIME

Ditën –
paradite, mbasдите,
Natën –
paramesnate, në mesnatë, pasmesnate
çdo trokëllimë më rrëqethte...
...më dukej si prangat,
sikur do vinte polici të më merrte
të më flakte në një shpellë
ku do tmerroheshin dhe tmerret.
Çdo trokëllimë...
Ç'do trokëllimë?...
Ç'kërkon?...
Një trokëllimë...
Vura veshin si me frikë...

Afër frëngjisë,
nëpër barin e paket-patkonj.
Kulloste një kalë

si dikur,
si në ëndërr.
Trupi i tij i bukur –
muzg i larë me shi dhe hënë.
Ç'e mirë të solli kështu?
Mos je ti Pegasi?!

Kam pasur edhe unë dëshira të blerta
Të njoma si bari.
Ca m'i kanë shkelur,
ca i kam mbajtur.
Ty po t'i hedh –
haji!
Dhe me buzët e thara
Mërmërita ngadalë

Siç mërmëritet nëpër dashurira:
– Kalë, o kalë...

Ngriti kokën,
u pamë sy më sy.

Kisha kohë pa u parë në një pasqyrë,
pothuaj e kisha harruar fytyrën time,
u pashë në sytë e kalit
kaq shumë njerëzorë
dhe me një si brengë shndritëse.
Isha i qethur tullë,
pis dhe me mjekër...
U mënjanova
se mos i duksha kalit i egër.

Dhjetor 1979

RRESHTI I KËPUCËVE TË BURGOSURA (Spaç, 12.VI.81)

Flenë të burgosurit.
Me një batanije të vjetër vegimesh
mbulojnë trupin e lodhur.

Ja dhe këpucët e tyre po dremitin në rresht
me një besnikëri të përbaltur qensh.

Opinga-a nuk të kujtojnë plisat e arave?
Çizme të prera
që vazhdojnë të jenë në armiqësi
me çizmet ushtarake.

Pantofla- të buta, të buta,
se si ndihen,
si mirësjellje e tepruar në burg.

Këpucë qytetare-
që keni njohur këpucë grash nëpër
takime,

që keni vallëzuar,
që keni shkëlqyer nëpër bulevarde,
që keni hyrë nëpër drama,
qani të braktisura nga gjithçka,
jeni vetë epilogu i dramës më të madhe.

Ja dhe këpucët e spiunit
me lidhësen që u varet si shpifja nëpër gojë.
Më mirë zbathur,
pa këmbë në fund të fundit,
jo me këto këpucë,

s'i shoh dot,
dot nuk i duroj.

Por ka edhe këpucë enigmatike, krenare
(siç ka dhe të shëmtuara)
këpucë që në shpirt,
ndoshta dhe në histori,
do të lënë gjurma.

Këpucë të burgosura,
më fatkeqet në botë,
të lodhura
të çara.

Kur jeta fut këmbët te ju,
shkon prapa, vetëm prapa.



Poezi të shkruara fshehurazi në burgun e Spaçit dhe të Qafë Barit, një pjesë të bëra me mend dhe të lexuara fshehurazi nga miqtë e ngushtë të autorit, të burgosur edhe ata, që mësoheshin edhe përmendësh prej tyre, sepse po të zbuloheshin, ridënoheshin njëlloj si autori dhe lexuesi. U fshehën në kashtën e dyshekëve, mes leckave të të burgosurve dhe nën tokë, derisa patën fatin të "lirohen nga burgu" edhe poezitë...

Një pjesë e tyre janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera, anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, rumanisht, kroatisht, hebraisht etj., madje edhe janë muzikuar.

Këto copa letrash janë dëshmi e gjallë se si vuajtja e madhe shndërrohej në vlerë shpirtërore, se si balta e dënimeve bëhej poezi, hakmarrja më e madhe ndaj së keqes...



ËNDRRAT

Ti po mbyll sytë, i dërrmuar
nga puna e tmerrshme këtu nën tokë.
Patjetër je duke ëndërruar,
se ëndrrave pranga s'u vënë dot.


Dhe le ta bëjnë ferr galerinë,
ti vuan që të mbetesh engjëll.
Mbi supe si flatra ke mirësinë
dhe fluturon nëpër ëndërr.

Ku shkon kështu? Ah, unë e di
dhe ëndrrat lodhen mes kaosit
dhe kanë ftohtë ashtu si ti
veç me kapotën e të burgosurit

dhe s'po të them që i vrasin ëndrrat
që kam shëtitur ndër varret e tyre.
Ndodh që na vrasin më parë se ëndrrat
dhe qajnë ato mbi ne si vejushë.

Befas u zgjove. Buzëqesh i trembur,
sapo u ktheve nga ai vend i lumtur.
Balli i mbushur plot me ëndërr
e di që bëhet më i bukur.

Spaç, dimër 1982



BIENALJA E VENECIAS

DHJETË NDALESAT

MË TË ZHURMISHME TË ARTIT

Edicioni i 58-të i Bienales së Venecias, i çelur këtë fundjavë, shfaq 90 pavijone dhe një ekspozitë, kuruar nga Ralph Rugoff, titulluar “May You Live in Interesting Times”, që në shqip do të përkthehej “Jetofshi në kohë interesante!” dhe që merr mallkimin kinez si pikë fillese për një shfaqje me artistë që po ndryshojnë botën në një kohë me trazira politike. Por alegoria e kësaj vere do të jetë: “Nëse një pavijon ka një radhë të gjatë, ia vlen pritja!” Sipas Rugoff-it: “Ndoshta arti, në mënyrë indirekte, mund të kthehet në një guidë se si të jetojmë e të mendojmë.” Bienalja, e cila do të qëndrojë e hapur deri më 24 nëntor në Giardini dhe Arsenale të Venecias dhe në 21 sheshe nëpër qytetin pluskues, është më shumë sesa një thirrje dhe përgjigje ndaj ciklit të lajmeve të përditshme. Ky edicion i 2019-s është i mbushur me protesta vallëzimi, video-art i çuditshëm, një aplikacion për ndryshimin klimaterik dhe një shpellë e bërë prej floku sintetik. Ja disa nga veprat më të zhurmshme të artit, nga Islanda, Tajvani, Brazili dhe... Shqipëria e cila këtë vit përfaqësohet me Driant Zenelin dhe parabolën e tij artistike të minierës së Bulqizës.


Kromo Sapiens-i në pavijonin e Islandës

Shoplifter, a.k.a. Hrafnhildur Arnardóttir, njihet për bashkëpunimet e saj me këngëtarin Björk, por është gjithashtu e njohur për instalacionet gjigante të gëzofta me flokë sintetikë. Jo e zakonshme floknajë brune dhe bionde, por e gjelbër fosforeshente, blu pastel dhe rozë e ndezur që hijeshon muret e instalacioneve të saj të ngjashme me shpellat vullkanike. Kjo vepër është e vendosur në magazinën e ishullit Giudecca, ka një cilësi të ngjashme me mitrën. I tërheq vizitorët nga terri drejt dritës. I thyen edhe rregullat “Mos prek artin” gjithashtu, ndërsa vizitorët inkurajohen të përqafojnë hejet që varen nga tavana.

Plazhistët operistikë të Lituanisë që i këndojnë ndryshimit klimaterik

Fituesi i “Luanit të Artë” të Venecias për pjesëmarrjen kombëtare gjendet pranë Arsenale-s në një tjetër ish-vendndodhje të marinës, të rrëmbyer tashmë nga tre artistët lituanë: Rugilė Barzdžiukaitė, Vaiva

Grainytė dhe Lina Lapelytė. Me ndihmën e 35 tonë rëre lituane, ata e shndërruan sheshin në një plazh të stisur për Sun & Sea (Marina), një pjesë performance e realizuar nga “plazhistë” që këndojnë një opera rreth ndryshimeve klimaterike. Është hera e dytë që çmimi i shkon një pjesë performuese. Më 2017-n, fituesi ishte pavijoni gjerman për “Faustin” magjepsës të Anne Imhof-it. Kuratorja e pavijonit lituan, Lucia Pietroiusti, e cila është edhe kuratore e programeve të ekologjisë



në Galerinë Serpentine të Londrës, ka thënë se kjo pjesë nisi si një performancë pak më e gjatë teatri në lituanisht. Ajo i inkurajoi muzetë të mendonin jashtë kornizave. “Formati i ekspozitave po lutet për një lloj hapjesh të mundësive”, - tha ajo. - “Ne specializohemi aq shumë, krijojmë këto pjesë specialiteti. Pastaj hasim këto situata të mëdha katastrofike, si ndryshimi klimaterik apo zhdukjen e specieve, dhe kemi nevojë të gjejmë mënyra të reja për t’u lidhur”.

Arthur Jafa, “Luani i Artë” i Venecias

Një tjetër çmim i madh “Luani i Artë” për pjesëmarrësin më të mirë në ekspozitën qendrore të Bienales i shkoi artistit dhe kineastit amerikan Arthur Jafa. Ai shfaq një film 50-minutësh, titulluar “Albumi i Bardhë”, në të cilin pranëvendos manifeste të epërsisë së bardhë me portrete të njerëzve të bardhë, të cilët i do dhe i ka pranë. Ai shfaq edhe një seri skulpturash monumentale me gomave traktorësh në zinxhirë.

Në pavijonin zviceran lëvizet së prapthi


Protesta e vallëzimit me video-art është potencialisht projekti më gumëzhitës i bienales. Të lëvizësh



mbrapsht, që i bën valltarët të lëvizin për të kapur ritmet dhe teknon në kah të kundërt, mund të kthehet në trendin e së ardhmes. Kuptimi më i thellë? Simbolizon rezistencën kundër politikave regresive. Letra e artistëve për shikuesit në mur i pyet të gjithë: “A ndiheni ndonjëherë sikur po detyroheni masivisht për të ecur mbrapsht?” Valltarët në video janë të veshur me kapela, pantallona me temina dhe funde, duke tërhequr vëmendjen e vizibilitetit jobinar. Kjo vepër lidhet me teoricienin queer José Esteban Muñoz, i cili është shprehur se e tashmja është një “shtëpi-burg”. Lëvizja pas është rryma e re e lëvizjes përpara, ose “e anasjella”, thonë artistët.

Një qeli burgu në pavijonin e Tajvanit

Pionierja i artit të internetit Shu Lea Cheang punon në realitetin digjital që përpara se të lindnin shumë prej gjeneratës së “Mijëvjeçarëve” (në fillim të viteve ’90). Tani, ajo sjell një aplikacion dhe një ekspozitë të titulluar “3x3x6”, duke iu referuar përmasave të një qelie burgu. Ekspozita e saj, që është në Palazzo delle Prigioni (një burg i shekullit XVI), komenton në shtetin aktual të vëzhgimit dhe rreziqet e njohjes së fytyrës dhe celularëve inteligjentë. Në 10 filma të shkurtër, ajo



paraqet raste ligjore ku njerëzit janë burgosur për shkak të moskonformizmit gjinor apo racial. Artistja thotë se filmat mbajnë qëndrim për “dinjitetin vetëafirmues kundër shtypjes”.

“Lindja” e Marina Abramović-it në Ca’ Rezzonico

Kumbara e artit performues po flet me gjuhën më të përhapur digjitale: video-lojërat. Në Galerinë Ca’ Rezzonico, artistja tërheq vëmendje në nivelet e baticave me ekspozitën e fundit dhe aplikacionin “Rising”. Futuni në një palë syze dhe kufje VR për të ndjekur artisten e shndërruar në avatar në skenarin prej video-loje; ajo është një personazh që ka nevojë të shpëtohet nga mbytja në një cisternë të qelqtë në Arktik, rrethuar nga kube akulli që shkrijnë. Vetëm bëmat e mira në ndihmë të mjedisit mund ta shpëtojnë atë nga dëshpërimi. Fotot e procesit të realizimit të aplikacionit janë gjithashtu të ekspozuara, po ashtu edhe videot shoqëruar me komente.

Lufta e valleve në pavijonin e Brazilit

Megjithëse Brazili është në sundim konservator, pavijoni i tij është gjithçka tjetër veç konservatorit. Videoja kremton swinguerra-n, një fenomen vallëzimi në qytetin e Recife-s, ku grupe të rinjsh luftojnë në një konkurs të përvitshëm vallëzimi. Del si një video muzikore me koreografi, por swinguerra është gjithashtu një sport garues. Duke shkruar hip-hopin me sambën, është një komunitet përfshirës, i nëndheshëm me valltarë jobinarë. Kuratori Gabriel Perez-Barreiro





thotë se kjo video është në thelbin e “debatet mbi vizibilitetin, të drejtat ligjore dhe vetëpërfaqësimin” e vendit.

Djali i Anthony Quinn-it ndërton ura në Arsenale

Pas suksesit të tij në Bienalen e fundit të Venecias, artisti Lorenzo Quinn (i biri i aktorit meksikano-amerikan Anthony Quinn) është kthyer me gjashtë palë duar monumentale në Arsenale, në dokun lundruar, për një instalacionin të titulluar “Ndërtimi i urave”. Secila palë e duarve të përkthyer ka një simbol të ndryshëm që përfaqëson vlerën njerëzore, nga miqësia te shpresa dhe besimi. Duart prej rrëshire artificiale janë 15 metra të larta dhe Andrea Bocelli ngriti grushtin bashkë me artistin në zbulimin e veprës, javën e shkuar. Frymëzimi i Quinn-it ishte “kapërcimi i dallimeve dhe ndërtimi i një bote më të mirë”.

“Liria e Ganës” në Venecia

Kurrë në historinë 124 vjeçare të Bienales së Venecias, Gana nuk ka pasur një pavijon deri tani. Për ekspozitën përruese, arkitekti ganez-britanik David Adjaye ka skicuar gjashtë dhoma rrethore me mure të mbuluara me baltë nga Gana. Gjashtë artistët janë të ekspozuar si pjesë e “Lirisë së Ganës”, që e merr emrin nga një këngë e 1960-s, të E.T. Mensah, shkruar pasi vendi fitoi lirinë më 1957-n. Veprat përfshijnë portrete nga piktorja Lynette Boaky-Yiadom, foto nga Felicia Abban dhe video me tri kanale nga John Akomfrah, që kombinojnë një material nga periferia e Ganës me momentet historike në politikën afrikane. Gana është i teti shtet afrikan që merr pjesë në Bienalen e Venecias. Edhe Mozambiku merr pjesë për herë të parë më 2019-n.

Miniera e Bulqizës në kozmosin e artit ndërkombëtar

Në këtë edicion të 58-të Shqipëria përfaqësohet me artistin Driant Zeneli me video-instalacionin “Maybe dhe Cosmos is not so extraordinary”, kuruar nga Alicia Knock. Ceremonia u çel nga ministrja e Kulturës, Elva Margariti, sipas së cilës është bukur që Shqipëria prezantohet në këtë kozmos artistik me një vepër që lind në Bulqizë dhe tejkalon kufijtë lokalë, për të përcjellë një mesazh shumë më universal. “I bashkohemi kësaj bienaleje me një thyerje dimensionesh, duke sjellë histori të vogla, nga qytete të vogla, e duke i kthyer në art bashkëkohor dhe në dimensionin e së bukurës. Jemi të ndërgjegjshëm që arti i tij sjell edhe një polemikë, mbi të cilën do të doja të reflektonim dhe të diskutonim”, - do të shprehej ministrja Margatiti. Kuratorja Alicia Knock u shpreh se vepra e Zenelit shpreh se si ëndrrat mund të bëhen realitet. “Vepra e Driantit flet për një realitet specifik të Shqipërisë, të Bulqizës, të kromit, që udhëton nga zemra e malit drejt kozmosit”, - thotë Knock, teksa përshkruan një udhëtim gjeopolitik, ekonomik, industrial, në veprën e Zenelit. “Ky kozmos nuk është ndërtuar vetëm nga unë, por shumë persona që kemi punuar për një vit për të realizuar këtë vepër, duke filluar nga këta 5 heronj që janë protagonistë të veprës. Vepra ime u dedikohet të gjithë atyre që besojnë në ëndrra dhe kërkojnë çdo ditë të shtynë limitet e tyre”, - u shpreh artisti Driant Zeneli. Në ceremoninë e çeljes së pavijonit shqiptar të pranishëm ishin edhe artistë të njohur, si Anri Sala, i pari shqiptar në Bienalen e Venecias, ku ka përfaqësuar vite më parë Francën, Adrian Paci, Edi Muka, Alban Muja, Anila Rubiku e shumë të tjerë.


BARËRAT E SË KEQES

Nga Shkëlqim Çela

Rasi një rrufe në të kthjellët: mëhalla konservatore “Dymbëdhjetë lisat” u bë papritur skena e një krimi! Stacionet televizive lokale nxituan ta jepnin ngjarjen si kryelajmin e ditës. Fytyrat e folësve që nga ekranet, megjithëse të mësuar me gjithfarë ndodhish e ngjarjesh të habitshme, nuk mundën ta fshihnin dot një hutim të singertë. Çne vrasje tek “Dymbëdhjetë lisat”?! Një mjedis i qetë, ku klasa e mesme kalon në limonti jetët e mesme dhe ku e vetmja zhurmë që ndihet është ajo e korres së herëpashershme të barit para shtëpive. Vërtet që bota po çmendet, Xhejms, nuk është vetëm ngrohja globale, as edhe ajo shakaja e keqe, sipas së cilës si lojtari më i mirë i golfit, ashtu edhe presidenti i Shteteve të Bashkuara, janë të zinj. Sikundër këngëtari më i mirë i rap-it është i bardhë. Jo, jo, gjërat po shkojnë vërtet shumë larg! Si drejtin shkojnë e vrasin postierin në një mëhallë ku njerëzit ruhen mos trembin ketrat dhe ushqejnë gjer edhe korbat me koncentrat të blerë enkas?! Pastaj, a nuk thuhet “mos e vrit lajmëtarin”? Kushedi ç’lajm të zi do të ketë sjellë, i ziu postier... qyqari.


Ishte vërtet e pashpjegueshme se ç’e kishte sjellë punën deri aty. Në mesditën e qetë të mesjavës, një të mërkure pa karakter e pritshmëri, pak pasi postieri kish mbërritur me makinën e bardhë, të vogël e paqësore të postës, ishte dëgjuar një krismë arme, e po ashtu fare pak më pas ishte dëgjuar kuja e urgjencës dhe e makinave të policisë.

Shkakun e vrasjes e morëm vesh më vonë. Ishte një motiv i dobët, siç u thonë tani shkaqeve vetjake për krim. A nuk i dëgjojmë kaq shpesh? Mirë thua që bota po merr kot, shtohet obeziteti dhe dobësohen motivet - më fal, e di që nuk ka vend për shaka, aq më tepër për shaka të dobëta, por gjithë fajin e kishin atoulet që njëri nga gjitonët i kishte mbjellë rreth kutisë së postës: ca erëza të çuditshme mesdheu që ne i njohim vetëm përmes shishkave e kutive të vogla tek raftet e erëzave në shitoret organike dhe tregun e bujkut, por që na qenkeshin edhe bimë të vërteta, gjithfarë lavandrash e nenexhikësh e rigonësh që rriten në ato nahije të botës, erëza që e joshnin postierin, kushedi pse, njërin prej postierëve më saktë, thashë nuk dihet pse, për kushedi ç’arsye, fare kot xhanëm, një sebeb duhet për jetëshkurtërin, ose mbase ishte nga ato anë, thashë nuk dihet pse, por nejse. Ai i ndjeri teksa fuste shukun e zarfeve dhe revistave në kuti, rrinte me gjatë se zakonisht të merrte atë erëzim, që kushedi ç’i kujtonte, e mallëngjehej ashtu, me fllad rivierash e brigjesh mesdheu që i shohim tek-tuk në TV, dhe njëri nga gjitonët, tek e shihte ashtu si të përmalluar, ra në dyshim se mos postieri i bënte isharete së shoqes, e cila për dreq edhe qëllonte të ish aty pari shi kur s’duhej, duke prerë ndonjë trëndafil-a, duke pirë ndonjë kafe për qejf-a, dhe aq është. Idili i pandehur është gjëja më e lehtë për t’u ngjizur, përkimet në këto raste s’mungojnë kurrë, janë ngjitëse ojnate, mu si kotja prej gjumit, e kështu mllef i gjitonit erdh e t’u bë si një krusmë përbindëshe në zgavër të shpirtit e lukthit, derisa një ditë mori armën dhe ... krisëm..., e qëlloi pa një, pa dy...



Ndaj nuk duhen sjellë bimë të huaja, Xhejms, ndaj edhe në aeroporte të pyesin mos ke marrë dhe të huaj, bimë të huaja, mos ke fjetur pranë gjedhësh të huaja... S’u thonë kot bimë eterike, kupton, kushedi ç’dheje ka marrë i ziu postier, ç’kushtrim i vjetër i sojit të vet e ka thirrur, në pastë qenë nga ato vise sikundër thua, imagjino të jetosh në të atillë vend të mbushur me lloj-lloj sherebelash e çajrash endemike, e dhjozmash të çuditshme, e këngësh të vjetra që i bëjmë në shkollë, nuk është çudi që dëgjojmë për të vlarë aq shpesh andeja... ruajna Zot e të faleminderit që s’na linde atje, në ato ckërka e shkëmbinj sirenash plot me fole gjarpërinjsh e kushedi ç’akrepë helmues e fiq të nxehtë hardallosës shkëmbi e deti. Meqë ra fjala, bari ynë para shtëpisë ngriti krye përsëri, duhet prerë, gjitonët kanë dy orë që kanë filluar. Ç’pret akoma, Xhejms?

Fragment nga libri i ri "Barërat e së keqes", botimet Pegi



SHKËLQIM ÇELA
BARËRAT E SË KEQES



G. G. MÁRQUEZ

SHQIPËRIMI I PARË NGA ORIGINALI
MIRA MEKSI

njëqindvjetvetmi

OnufriRoman

